DOKUMENTI STRATEGJIK I ORCA-s 2025-2029

Prishtinë, korrik 2024

Përmbajtja

HYRJE.....4RRUGA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË 2025-2029 6
Vizioni i dokumentit strategjik të ORCA-s 2025-2029.....7
HISTORIKU I ORCA-S 8
VIZIONI DHE MISIONI I ORGANIZATËS 9
VEPRIMTARIA DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË ORGANIZATËS 10
ANALIZA E GJENDJES POLITIKE, EKONOMIKE, SHOQËRORE, TEKNOLOGJIKE, AMBIENTALE DHE LIGJORE 11
Politika 11
Ekonomia 12
Shoqëria 13
PISA 2022 13
Mungesa e ndërlidhjes së universiteteve me industrinë.....13
Studentët 14
Nxënësit e shkollave të mesme 15
Shoqëria drejt diskutimeve të reja sipas trendeve globale.....15
Çështja gjinore 16
Teoritë konspirative si mjet për rritjen e cënueshmërisë së të rinjve 17
Teknologjia 17
Dilemat e reja etike në epokën e Inteligjencës Artificiale 17
Ambienti 18
Ligjorja 18
Statuti i ri i UP-së.....19
Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim 19
Fusha e intervenimit: Hulumtimi dhe Monitorimi 21
Fuqizimi i hulumtimit me inteligjencë artificiale 21
Krijimi i Platformës për Rangimin Kombëtar të Universiteteve 21
Raporti gjithpërfshirës: Enciklopedia e Arsimit të Lartë.....22
Monitorimi sistematik i të gjitha institucioneve të arsimit të lartë 22
Fusha e intervenimit: Aktivizmi, avokimi dhe rrjetëzimi.....23
Aktivizmi 23
Qendra e aktivizmit studentor.....23
Grantet për studentë.....23

Kongresi i Aktivizmit Studentor 24
Avokimi i suksesshëm i organeve të Kongresit 24
Përfshirja rajonale në Kongresin e Aktivizmit Studentor 24
Impakti i Kongresit në rajon 24
Avokimi 24
Nga raportet e gjata tek videot e shkurtëra 24
Aksionet simbolike si mjet për edukim 25
Teknologjitë e reja zëvendësojnë shërbimet e kushtueshme 25
Prioritizim i përdorimit të rrjeteve sociale 25
Podcast për arsimin 26
Qendra e trajnimeve 26
RRJETËZIMI 26
Rrjetëzimi në nivel kombëtar 26
Solidariteti - Reagimi i përbashkët me organizata të shoqërisë civile 26
Rrjetëzimi në nivel rajonal 26
Fusha e Intervenimit: Adaptimi me teknologjitë e reja 28
Fusha e intervenimit; Menaxhimi, procedurat dhe qëndrueshmëria e organizatës 30
ORCA kampion i transparencës 30
Menaxhimi dhe procedurat 31
Avancimi i mëtutjeshëm i raportimit intern nga stafi, pa shkaktuar ngarkesa burokratike 31
Qëndrueshmëria financiare 31
Aavancimi i stafit 31
Plani i zbatimit dhe buxhetit 33
Korniza për vlerësimin e performancës 35
Korniza për vlerësimin e rrezikut 36
Shtojca 1: Analiza SWOT 37
Shtojca 2: Plani i veprimit 39

HYRJE

Ndahet me të tjerët, nuk zvogëlohet por rritet: dija.

Është një gjë që kur ndahet me të tjerët nuk zvogëlohet, por rritet. Kjo është dija. Dija është parakusht i lumturisë së njeriut. Dija është parakusht i progresit e mirëqenies njerëzore. E në vitet e fundit kemi parë se si dija çdo herë e më shumë po bëhet parakusht i cilësisë së demorkacisë, në botën përplot dije të rreme që dezorientojnë njerëzit. Pra dija e gabuar është po aq, në mos edhe më e rrezikshme se mosdija. Prandaj, lufta për cilësi të dijes është lufta më fisnike që mund të bëjë sot njeriu.

Angazhimi i ORCA-s që të ndërhyjë në institucionet përgjegjëse për krijimin e dijes, është një orientim humanist i pjesëtarëve të saj. Arsimi është mjeti i shoqërisë për ta siguruar mirëqenien e vet. Arsimi cilësor do të sjellë dije cilësore, e dija një demokraci të qëndrueshme, e demokracia e qëndrueshme mirëqenie kolektive dhe paevitueshëm njeri të lumtur pjesëtar të atij kolektivi.

Jorastësisht vet organizata në emrin e saj e mban misionin e vet: rritjen e cilësisë në arsim. Sepse arsimi cilësor është çelësi i zhvillimit të një vendi, aq më tepër i një vendi si Kosova që shumicën dërrmuese të popullsisë e ka të re.

Pas pothuajse 7 vitesh të themelimit, ORCA ka mbërritur në një stad tjetër zhvillimi. Pas një lufte të ashpër të nisur me themelimin e saj, për ta vendosur parimin që vlerësimi i punës akademike të bazohet në indikatorë të matshëm me validitet ndërkombëtar, gjë që u arrit pas miratimit të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe Statutit të ri të Universitetit të Prishtinës, ku u betonua parimi që puna shkencore dhe kredencialet akademike të maten me kutin akademik të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (European Higher Education Area - EHEA), ORCA në njëfarë mënyre përmbushi një pjesë domethënëse të misionit të saj. Fundi i vitit 2023 dhe viti 2024 ishin kohë reflektimi për t'u ridrejtuar në orientime programore e po ashtu për ta ridefinuar rrugën drejt përmbushjes së misionit tonë: rritjes së cilësisë në arsim.

Çka do të thotë sot cilësia në arsim? Për kontekste të ndryshme përgjigjet janë të ndryshme. Për Malalan, cilësia në arsim do të thotë përfshirja e vajzave në të, për Greta Thunberg cilësia në arsim do të thotë përfshirja e programeve për mbrojtjen e ambientit në kurrikulën shkollore, për aktivistët e Shqipërisë do të thotë pagesa të përballueshme për semestër pasi pagesat për semestër atje janë tejet të larta, e kështu me radhë. Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që për vite me radhë arsimin publik e kishte shumë të lirë, ndërkaq në vitet e fundit e ka pa pagesë. Përfshirja e vajzave nuk është problem pasi shumica domethënëse e studenteve janë vajza në sistemin publik të arsimit të lartë.

Sfidat deri diku bazike të vendeve në zhvillim Kosova i ka kaluar, në kuptimin e përfshirjes gjinore e ekonomike, infrastrukturës, e të ngjashme. Por, Kosova vazhdon të mbetet një nga vendet me performancën më të dobët në testin PISA ku doli se 83% e nxënësve të saj nuk dijnë të lexojnë, apo thënë më saktë: ata shqiptojnë fjalët, por nuk arrijnë ta kuptojnë tekstin që kanë lexuar. Kjo gjendje e njeriut, në sesionin e 20-të të UNESCO-s në vitin 1978 u përshkrua si "analfabetizëm funksional".

Nga duhet të fillojmë? Diskutimi për atë se nga duhet filluar reforma, te bankat e klasës së parë apo te auditoriumet e universiteteve, vazhdon të jetë i pranishëm mes dy grupeve: njërit që mendon se gjithçka

duhet filluar nga arsimi parauniversitar dhe tjetrit që mendon se gjithçka fillon në arsimin e lartë. Ndonëse në dukje paradoksal, të menduarit që reforma duhet të fillojë nga arsimi i lartë ka një shpjegim prapa vetes. Arsimi i lartë i prodhon mësuesit, mësuesit i mësojnë nxënësit, nxënësit testohen në PISA. Pra për ta ndërruar cilësisht arsimin në shkolla fillore dhe të mesme, ndryshimet duhen filluar aty ku prodhohen mësuesit, pra në universitet. ORCA i takon këtij grupi dhe angazhohet për transformime në arsimin e lartë. Natyrisht, çdo iniciativë e ndryshimit të niveleve të tjera të arsimit, është e mirëseardhur, e përkrahur dhe e fuqizuar nga ORCA.

Si duhet të veprojmë? Pas ndryshimeve domethënëse në legjislacion, me miratimin e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe Statutit të ri të Universitetit të Prishtinës, priten transformime cilësore në arsimin e lartë. Vëmendje duhet kushtuar akteve nënligjore që do ta përshkruajnë në detaje rrugën e zbatimit të këtyre ligjeve, dhe vendosjen e praktikave në zbatimin e tyre. Monitorimi i kujdesshëm edhe për 1-3 vjet është i domosdoshëm. Në anën tjetër, një garant i qëndrueshmërisë së arritjeve dhe avancimit të tyre do të ishin studentët. Megjithatë, betonimi në ligj dhe statut i disa kritereve bazë është një siguri e cila na lejon të lëshohemi në ide të reja për rritjen e cilësisë në arsim.

Ne në ORCA menduam se dy janë drejtimet kryesore në të cilat ne duhet fokusohemi: informimi periodik i publikut për arsimin e lartë dhe puna me hisedarët kryesorë të tij, studentët.

Ne e pamë të nevojshëm transformimin e kritikës sonë që duket si një shkop ndëshkues, në diçka që ka edhe karrotën si shpërblyese. Dhe kjo ishte ideja për krijimin e një mekanizmi të rangimit në nivel kombëtar të universiteteve. Këtë e quajtëm Platforma e Rangimit Kombëtar të Universiteteve. Për ta bërë këtë, gjatë vitit 2023 eksploruam mundësitë që metodat tona hulumtuese të fuqizohen nga "scratching tools" dhe nga inteligjenca artificiale, që të shkurtohet koha e mbledhjes së të dhënave. Kështu do të ishte e mundshme që ne të bënim një shqyrtim cilësor të universiteteve dhe të vinim me një rangim të përvitshëm të performancës së tyre. Rangimi vjetor i tyre do të ishte shkopi që ndëshkon ata që performuan dobët dhe karrota që shpërblen ata që u përmirësuan. Kështu, do të kalonim nga "tifozi" që brohoret herë i gëzuar e herë i hidhëruar për zhvillimet në arsim, në "arbitrin" që mbron kualitetin e arsimit të lartë.

Në anën tjetër, vendosëm që punën e intensifikuar me studentë në 4 vitet e kaluara ta vazhdojmë. Rezultatet që dha puna me ta ishin premtuese, ku vlen të përmendet se nga grantet që ka dhënë ORCA për projekte të grupeve joformale studentore në një periudhë 3 vjeçare, në aktivitetet e tyre morën pjesë rreth 10,000 studentë, ndërkaq në aktivitet e ORCA-s që nga themelimi i saj 4,511 studentë, gjysma e tyre ishin vetëm në 3 vitet e fundit. Këta numra tregojnë se mendimi që mbizotëronte në Kosovë se studentët janë apatikë nuk është i vërtetë. Mbetet sfidë gjetja e mënyrës më të mirë për angazhimin e tyre, pasi zhvillimet radikale teknologjike dhe shoqërore të dekadës së fundit që kanë formësuar të rinjtë në nivel global kanë zhvilluar një ndarje gjeneratash edhe mes atyre që dallojnë pak ose mesatarisht në moshë. Pavarësisht këtyre, ne besojmë se përmirësimet në infrastrukturën ligjore dhe në performancën e përgjithshme të arsimit të lartë që tregohet me rritjen e publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare, rritjen e numrit të projekteve hulumtuese të universiteteve, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në universitete, përmirësimet e përqindjeve në justifikimin e titujve akademikë, janë edhe si rezultat i rritjes së aktivizmit studentor.

Përfundimisht, ne në ORCA besojmë se me përmirësimin e vetes sonë, pra të metodave tona hulumtuese e avokuese, aftësive tona monitoruese, përpjekjeve për angazhimin e aktivistëve, angazhimit tonë për rrjetëzim kombëtar e rajonal, përdorimit të teknologjive të reja, ne do të jemi më afër, ndonëse kjo është një përpjekje që s'mund ta shohë kurrë fundin e vet, në jetësimin e emrit që mbajmë me krenari: Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim.

RRUGA PËR HARTIMIN E STRATEGJISË 2025-2029

Me rastin e afrimit të përfundimit të afatit të dokumentit strategjik ekzistues të ORCA-s 2020-2024 ishte koha që në fillim të vitit 2024 të fillonte procesi i hartimit të strategjisë së re. Periudha e mbetur deri në vitin 2025 u pa si periudha e nevojshme tranzitore për kapërcimet e nevojshme në metodologjinë e veprimtarisë së saj hulumtuese si dhe komunikimin me publikun. Ndryshimet domethënëse në legjislacion pas miratimit të Statutit të ri të Universitetit të Prishtinës dhe Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, e bënë urgjente ridefinimin e hapave që do të ndiqen deri në fund të vitit 2029.

Transformimet teknologjike të pak viteve të fundit si futja e Inteligjencës Artificiale në dizajn, video editim, shkrim të teksteve, përkthim të teksteve, mekanizma hulumtimi, mbledhje informacionesh, pothuajse në secilën fushë të veprimtarisë, e bënë të paevitueshme nxjerrjen e një strategjie të re.

Ky dokument strategjik adreson të gjitha inovacionet teknologjike dhe përgatitë ORCA-n drejt adaptimit me to dhe përfitimit nga to. Paparashikueshmëria e avancimit teknologjik e bënë këtë dokument një dokument tranzitor drejt një faze të re të zhvillimit të organizatës nëse transformimi i viteve të ardhshme është i suksesshëm. Rishikimi i tij dhe plotësimi i tij mund të jetë i nevojshëm në frekuenca më të shpeshta, me qëllim të të qëndruarit në hap me zhvillimin e hovshëm të mundshëm teknologjik në vitet në vazhdim. Si rrjedhojë krijimi i një dokumenti dinamik dhe lehtë të adaptueshëm në situata të reja të zhvillimeve socio-politike që mund të vijnë edhe si pasojë e zhvillimit teknologjik, ishte qëllim i kësaj ndërmarrje të stafit të ORCA-s për krijimin e një dokumenti strategjik.

Fushat e Intervenimit që u definuan në punëtorinë e stafit të ORCA-s ishin:

1. Hulumtimi dhe monitorimi;
2. Aktivizmi, avokimi dhe rrjetëzimi;
3. Adaptimi me teknologjitë e reja;
4. Menaxhimi, procedurat dhe qëndrueshmëria e organizatës;


Mbi bazë të këtyre fushave u identifikuan orientimet e reja strategjike dhe u nxorrën masat dhe aktivitetet, të cilat mundësuan një plan të detajuar buxhetor të zbatimit të tyre.

Vizioni i dokumentit strategjik të ORCA-s 2025-2029

2025:
ORCA angazhohet në 3 komponenta: 1. transformon veten teknologjikisht dhe metodologjikisht, 2. krijon Platformën e Rangimit Kombëtar të Universiteteve dhe Enciklopedinë e Arsimit të Lartë, 3. fuqizon studentët si pjesë e vendimmarrrjes në arsimin e lartë.

2027:
Si rrjedhojë bëhen 3 transformime: 1. rritet aftësia e ORCA-s për ndryshime pozitive në kualitetin akademik të arsimit të lartë, 2. fillon konkurenca e universiteteve publike për përmirësim të cilësisë, 3. rritet demokracia në arsimin e lartë ku hisedarët kryesorë – studentët – janë të përfshirë në vendimmarrje.

2030:
Arsimi i lartë në Kosovë është një ambient transparent, llogaridhënës dhe konkurues i gatshëm për të marrë pjesë në garën e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë *(European Higher Education Area - EHEA)*.



HISTORIKU I ORCA-S

ORCA u themelua në vitin 2016. Punën e filloi më 1 dhjetor të vitit 2016, ndërkaq paraqitjen e parë publike e pati më 15 shkurt 2017 kur publikoi raportin e parë të saj. ORCA u angazhua sistematikisht për integritetin akademik. Arriti me sukses që përmes presionit publik ta ndalonte avancimin jomeritor të stafit akademik përmes monitorimit konstant të mbledhjeve të Senatit të UP-së. ORCA ngriti disa çështje me rëndësi të cilat u bënë tema nacionale, që diskutoheshin në emisionet qendrore televizive dhe në rrjete sociale. Rasti më përshkrues ishte diskutimi për plagjiaturën. Pas aktiviteteve të ORCA-s, si denoncimet publike, arrestimi i aktivistëve të saj për protestën ku kërkohej që plagjiatorët të mos lejohen të ligjërojnë në universitet, tema e plagjiaturës u bë pjesë e diskursit publik si çdo temë tjetër me rëndësi. Faqet e njohura dhe masive satirike disa herë nxorrën imazhe kritikuese për plagjiaturën apo cilësinë e dobët në arsim si pasojë e saj, të cilat u ndanë masivisht nga publiku i gjerë, çka tregon se ORCA me sukses arriti të nxiste opinionin publik të fliste për tema që ajo mendonte se ishin me rëndësi.

Nga themelimi e deri më sot ORCA ka zhvilluar dhe përmbyllur me sukses 28 projekte të mbështetura nga 10 donatorë. Të gjitha raportet e auditimit ishin me zero gjetje për sa i përket shpenzimeve dhe pasqyrave, me përjashtim të letrave të menaxhmentit ku jepeshin udhëzime të cilat ORCA i zbatonte me sukses nga viti në vit.

Buxheti i ndarë vetëm për ORCA-n si fituese individuale e granteve apo si pjesë e konsorciumeve nga themelimi i saj deri më sot është 1,541,246.00 EUR. Deri më sot ORCA ka publikuar 36 raporte; ka bërë 199 monitorime; ka zhvilluar 350 aktivitete; 35 aksione simbolike; ka organizuar 5 kongrese ku kanë marrë pjesë 544 studentë aktivistë; ka ndarë 98,969.00 EUR grante për 50 grupe joformale studentore, në projektet e të cilave kanë marrë pjesë mbi 10 mijë studentë. Në aktivitetet e zhvilluara në zyrat e saj (përfshirë Qendrën e Aktivizmit Studentor në ORCA), kanë marrë pjesë *4,511 qytetarë, mbi 90% e të cilëve ishin studentë.*

Në vitin 2023, ORCA kishte një buxhet prej 244,315.00 EUR. 37% të tij ishin ndarë për paga, 44% për aktivitete dhe 19% për shpenzime administrative. Paga mesatare gjatë vitit 2023 ishte 1,077 EUR. E gjithë përmbajtja në rrjete sociale veç në vitin 2023 mbërriti te më shumë se gjysmë milioni njerëz, ndërsa faqja e Facebook-ut mbërriti në 85 mijë vizita, gati 3 herë më shume se ne vitin 2022 që kishte veç 28 mijë vizita. Deri më sot ORCA ka krijuar më shumë se 50 video, të cilat i kanë arritë mbi 1 milion shikime në Facebook. Vetëm në vitin 2023, videot e ORCA-s janë shikuar 389 mijë minuta.

VIZIONI DHE MISIONI I ORGANIZATËS

Vizioni:

Orientimi i shoqërisë kosovare drejt arsimit cilësor dhe konkurrent në hapësirën evropiane

Misioni

ORCA të jetë burim kryesor i të dhënave dhe ekspertizës në arsimin e lartë duke shfrytëzuar teknologjitë e fuqizuara nga Inteligjenca Artificiale, por edhe aktor i demokratizimit të mëtutjeshëm të arsimit përmes përfshirjes së rinisë.

VEPRIMTARIA DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË ORGANIZATËS

ORCA është organizatë joqeveritare që hulumton, avokon, promovon integritetin akademik dhe mobilizon rininë në demokratizimin e mëtutjeshëm të institucioneve në AL.

ORCA angazhohet për cilësi, transparencë, meritokraci dhe integritet në arsimin e lartë duke u angazhuar në veprimtaritë në vijim:

- Monitorimi, hulumtimi dhe raportimi për cilësinë e arsimit të lartë;
- Mbështetja e demokratizimit të arsimit të lartë të orientuar kah cilësia, meritokracia, transparenca dhe llogaridhënia;
- Zhvillim i mjeteve moderne të komunikimit me qëllim të informimit masiv të publikut për gjendjen në arsim dhe aktivitetet e ORCA-s;
- Përforcimi i administratës dhe financave, automatizimi dhe standardizimi i proceseve të brendshme;

Për të kryer këto veprimtari ORCA përcakton 4 objektiva:

Objektiva Strategjike 1: Të nxisë konkurrueshmërinë në arsimin e lartë
Objektiva Strategjike 2: Të rrisë demorkacinë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të studentëve si faktor garantues i qëndrueshmërisë së saj
Objektiva Strategjike 3: Të implementojë teknologjitë më të reja të mbështetura nga inteligjenca artificiale në avokim dhe komunikim me publikun.
Objektiva Strategjike 4: Të avancojë procedurat që sigurojnë menaxhim efikas të proceseve dhe të resurseve të organizatës si dhe të rrisë kapacitetet e veta me qëllim të sigurimit të një financimi të qëndrueshëm të organizatës.

ANALIZA E GJENDJES POLITIKE, EKONOMIKE, SHOQËRORE, TEKNOLOGJIKE, AMBIENTALE DHE LIGJORE

Politika

Deri vonë besohej se jostabiliteti politik në kuptimin e ndërrimeve të shpeshta të qeverive përgjithësisht dhe ministrave të arsimit në veçanti (ku në periudhën 2018-2021 ndërrohen 4 ministra), ishte faktori kryesor që ndikonte në mungesën e përparimit në arsim. Me ardhjen e qeverisë së re e cila gëzon një mbështetje të paprecedent në historinë moderne të Kosovës, u pa se ngecjet nuk kishin të bënin me jostabilitetin politik dhe fluktuimet e shpeshta të ministrave në dikaster, por me mungesën e vullnetit politik dhe kalkulimet elektorale të të gjitha partive që qeverisin me dikasterin e arsimit. Kanë kaluar gati 4 vite të qeverisë aktuale e cila është stabile dhe me një fuqi të madhe politike, po as edhe një ndryshim thelbësor nuk është parë të jetë ndërmarrë, përjashto ligjin e ri për tekstet shkollore i cili përbën një angazhim të veçantë të partisë në pushtet për të ulur ndikimin e grupeve të pushtetshme të interesit.

Çështje si miratimi i ligjeve që kanë të bëjnë me arsim nga shumica e dyfishtë (edhe e deputetëve minoritarë), pasë parasysh situatën aktuale ku deputetët e Listës Serbe që përbëjnë shumicën e deputetëve minoritarë dhe të cilët bojkotojnë Kuvendin deri në masën sa është e nevojshme për të ruajtur mandatin e tyre, duhen parë si faktorë rreziku që mund ta ndërprejnë reformën në arsim edhe në rast të vullnetit politik për një gjë të tillë. Shpeshherë ndryshimet ligjore apo hartimi i ligjeve të reja duhet t'u lënë rrugë formave tjera të rregullimit ligjor përmes akteve nënligjore. Kjo bën që kualiteti i ndryshimeve përmes akteve nënligjore të mos jetë i mjaftueshëm për nevojat në arsim për shkak të kufizimeve që imponon intervenimi përmes infrastrukturës ligjore dytësore (akteve nënligjore) e cila është e limituar nga ajo parësore (ligjet dhe kushtetuta).

Fokusi i publikut, i opozitës, medieve dhe shoqërisë në përgjithësi në situatën në veri të vendit si dhe negociatat me Serbinë, janë një faktor tjetër i rëndësishëm politik që kufizon aftësinë e shoqërisë për ta parë arsimin dhe problemet në të si prioritare dhe urgjente për shoqërinë.

Masat e BE-së ndaj Kosovës për shkak të përdorimit të instrumenteve shtetërore për të ushtruar sundimin e ligjit në territorin e vet, kanë ndikuar po ashtu në ngadalësimin e proceseve reformuese që varen nga fondet e BE-së dhe Agjenda Reformuese Evropiane apo mekanizmat konkret të saj si IPA apo të tjerë me rëndësi për proceset reformuese.

Ndërhyrja politike në zgjedhjen e menaxhmenteve të universiteteve vazhdon të jetë praktikë edhe në qeverisjen aktuale. Të paktën në 3 universitete publike nga 7 sa kishte në fillim të qeverisë aktuale, u ndërhy hapur për të bërë ndryshime në menaxhmente, më eklatanti nga të gjithë ishte ai i universitetit më të madh publik në vend, Universitetit të Prishtinës kur rektori i zgjedhur në mënyrë transparente u shkarkua në vitin 2022 me arsye të pamjaftueshme ose duke u fajësuar për çështje që nuk ishin në mundësinë e reagimit direkt të tij. Vlen të përmendet se në rastin e zgjedhjes së rektorëve të rinj, aty ku dyshohet se ka pasë ndërhyrje dhe ku janë vendosur rektorë që kanë ndonjë lidhje me pushtetin, Ministrja e Arsimit në formë të shprehjes së krenarisë publikonte rezymetë e gjata dhe të mirëhartuara paraprakisht të të zgjedhurve anipse procesi i zgjedhjes së tyre kalonte në votim të fshehtë. Këtë nuk e bënte në të gjitha rastet, çka tregonte se përgatitja e rezymeve kishte të bënte me rastet kur paraprakisht është ditur rezultati i votimit të fshehtë.

Gjendja e rënduar në arsimin e lartë është dëmtuar më tej nga kapja e mediave dhe politizimi i institucioneve të pavarura dhe të bordeve. Në një situatë të këtillë, nuk mjafton angazhimi zhvillimor i

OJQ-ve për përkrahjen e institucioneve të arsimit të lartë. Këtu kërkohet mobilizimi i komunitetit studentor përmes aktivizmit studentor, stafit akademik dhe administratës. Për një angazhim të tillë kërkohen edhe aktivitete që përfshijnë hisedarët përmes sensibilizimit të opinionit, mobilizimit të publikut, realizimit dhe publikimit të analizave dhe hulumtimeve së bashku me propozimet për ndërhyrjet konkrete pa përjashtuar format e rezistencës qytetare si aksione simbolike, protesta, greva etj.

Në disa raste, si ai i miratimit të Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim vërehej një aleancë e panatyrshme e deputetëve të pozitës dhe opozitës me qëllim të uljes së kritereve dhe standardeve të parapara në draftin e sjellë në kuvend ku ishin përfshirë ekspertë kombëtar e ndërkombëtar. Kjo tregon se grupet e interesit mund t'i kryqëzojnë artificialisht dhe në mënyrë të papritur interesat e pozitës dhe opozitës. Situata të tilla mund t'i ulin ndjeshëm kapacitetet reaguese dhe bindëse të OJQ-ve për publikun. I tillë ishte rasti i ndryshimit të Ligjit për Zyrtarët Publik, kur shefja e grupit më të madh parlamentar propozoi mocion për shmangie nga rregullorja me qëllim të amandamentimit të ligjit në fjalë për t'ju lejuar deputetëve që ishin edhe profesorë ta ushtrojnë pa penguar veprimtarinë e tyre akademike duke përfshirë avancimet e tyre akademike. Mundësia që deputetët apo zyrtarë të tjerë të fuqishëm politik të përdorin autoritetin e tyre politik për të marrë tituj akademik është e madhe pasë parashysh fragjilitetin e proceseve të avancimeve akademike apo punësimit të profesorëve në sektorin publik.

Për shkak të pjesëmarrjes së aktivistëve të ORCA-s në diskutimin publik mbi politikën u vërejt se në disa raste kishte një disponim të medieve për të bërë atakime të pabaza ndaj ORCA-s dhe aktivistëve të saj, në një rast madje edhe kryetari i një partie joparlamentare adresoi akuza të motivuara politikisht ndaj ORCA-s, çka tregon se në Kosovë ende ekziston një ambient ku qerimet e hesapeve politike bëhen në atë mënyrë që nuk zgjedhen mjetet e sulmit.

Ekonomia

Në dy dekadat e fundit, Kosova ka shënuar ritme paksa më të larta zhvillimore në rajon. Kosova nga një vend me të hyra të ulëta viteve të fundit kaloi në grupin e vendeve me të hyra mesatare të larta sipas kategorizimit të Bankës Botërore. Mirëpo, përkundër kësaj, Kosova mbetet vendi më i pazhvilluar në rajon dhe në Evropë. Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit, ndërsa për nga papunësia e të rinjve prej rreth 45% prinë në Evropë e më gjerë. Një shkallë e tillë e ulët e zhvillimit ekonomik doemos është reflektuar edhe në shkallën e investimit në arsimin e lartë. Kjo shkallë e investimit pastaj reflektohet edhe në efektivitetin e masave të ndryshme për përmirësim të arsimit të lartë.

Të dhënat statistikore të qeverisë për papunësinë nuk mund të merren si të besueshme meqë ato po nxirren me metodologji të atilla që të ulin numrin real, prandaj duhen parë raporte të tjera që tregojnë gjendjen reale të punësimit sidomos të të rinjve, shembull: ndonëse shkalla e papunësisë në vitin 2023 është 10.6%, pjesëmarrja në fuqi punëtore është shumë e ulët ku vetëm 40.9% të personave mes moshës 15-64 vjeç marrin pjesë në treg të punës. Tek të rinjët ky numër është edhe më alarmant, ku vetëm 22.4% e personave mes moshës 15-24 vjeç marrin pjesë në tregun e punës.

Masat në arsimin e lartë kanë shkallë të ulët të efektivitetit edhe për shkak të përdorimit joefikas të mjeteve në dispozicion nga qeveritë kosovare. Mënyra e financimit të institucioneve të arsimit të lartë karakterizohet nga ndarje lineare dhe shpesh arbitrare e fondeve dhe gjithnjë në dëm të cilësisë së veprimtarisë akademike e shkencore. Kjo vërehet sidomos te mënyra se si shpenzohet fondi për shkencë i cili jepet kryesisht për bursa studimi.

Tendenca e qeverisë për kursime në fusha tjera dhe shpenzime në ushtri dhe pajisje ushtarake mund të jetë një sfidë në të ardhmen për sa i përket koncensusit publik se arsimi i lartë ka nevojë për rritje të

buxhetit sidomos kur është fjala te shkenca e cila kërkon rritje signifikante të fondeve por edhe rritje të kapaciteteve për absorbimin e tyre.

Momentet e inflacionit global krijojnë pasiguri financiare për organizatat dhe mbajtjen e punëtorëve të tyre. I tillë ishte rasti i inflacionit global që erdhi pas fillimit të agresionit rus në Ukrainë. Shtrenjtimi i çmimit të energjisë elektrike dhe mallërave të tjera si pasojë e saj bëri që vlera e parave të ulet bashkë me fuqinë blerëse të qytetarëve.

Situata si ajo me pandeminë COVID-19 që ishin tërësisht të paparashikueshme dhe të papritura ndonëse nuk e sfiduan thelbësisht veprimtarinë e OJQ-ve, arriti të bënte tronditje ekonomike të tilla që rrezikuan punën për shumë punëtorë të organizatave të shoqërisë civile të cilat mund të ishin në përfundim të shpenzimit të granteve të fituara.

Ende nuk dihet impakti i liberalizimit të vizave për Kosovën nga janari 2024, meqë ky dokument është përpiluar disa muaj më pas. Vlerësimet e mëparshme ishin se kjo do të ndikojë në fuqinë punëtore e si rrjedhojë do të prodhojë sfida ekonomike zinxhirore. Deri në verën e vitit 2024 kur është përpiluar ky dokument strategjik, paralajmërimet e tilla nuk janë provuar të sakta.

Shoqëria

Ekziston një përshtypje në opinionin publik në Kosovë se organizatat e sektorit joqeveritar kanë shumë para dhe abuzojnë me to. Publiku ka mosbesim lidhur me përdorimin e fondeve nga OJQ-të duke dyshuar në pavarësinë e tyre duke i parë aktivitetet e tyre si të nxitura nga jashtë e jo nga baza.

Mosha e re e popullatës në Kosovë bën që arsimi i lartë të jetë nën presion. Sektori i arsimit të lartë karakterizohet nga prania e klisheve në kundrimin e aspekteve të ndryshme të arsimit të lartë, si për shembull orientimi kah diploma ose qëndrimi ndaj praktikave korruptive në universitet.

PISA 2022

Rezultatet e testit PISA të vitit 2022, të cilat u publikuan gjatë vitit 2023 ishin shokuese për publikun kosovar. Nga 76% sa ishte përqindja e nxënësve që nuk dijnë të lexojnë në rezultatet e vitit 2018, ajo ishte rritur në 83% në ato të vitit 2022. Kjo tregon se masat që janë marrë nga publikimi i rezultateve të vitit 2018 janë të gabuara dhe nuk kanë dhënë as efekt parandalues e jo më të përmirësimit të gjendjes. Me një numër kaq të madh të nxënësve nën nivel, cilësia e arsimit të lartë është paevitueshëm e kompromentuar. Pavërejtshëm ndodh që në sektorin e arsimit të lartë të zbuten kriteret e pranimit, vlerësimit dhe kalueshmërisë. Ndonëse kjo në universitete publike është më e butë, ekziston një përshtypje e përgjithshme se sektori privat ka një sistem kriteresh të orientuar drejt pajisjes me diplomë të klientëve (studentëve të kolegjeve private) duke qenë se kjo është pritja e tyre ndaj operatorëve ekonomik biznesor (siç janë të kategorizuara kolegjet private).

Në Kosovë arsimi i lartë shihet si vazhdim i arsimit të mesëm dhe adresë për marrjen e një diplome – jo gjithnjë në profile që garantojnë punësim dhe jo gjithnjë të shoqëruar me kualifikimet dhe kompetencat përkatëse. Kjo ka bërë që të shtohen kërkesat për rritjen e mundësive për studime dhe, njëkohësisht, ka ndikuar negativisht në cilësinë e shërbimeve të arsimit të lartë. Një qasje e këtillë populiste dhe jo shumë produktive është përdorur nga disa grupacione politike për përfitime politike. Po kjo qasje ndikon substancialisht në qëndrimin shpesh herë negativ ndaj OJQ-ve që insistojnë në cilësi në arsimin e lartë në Kosovë.

Mungesa e ndërlidhjes së universiteteve me industrinë

Rënia e ofertës për kualifikim në fushën e shkencave të aplikuara ka bërë që të humbet relevanca e shkollimit të lartë. Studimet universitare shihen si status social ose si shtyrje e problemeve sociale para se të shihen si burim i kualifikimit për nevoja të tregut dhe i punësimit. Ngjashëm me arsimin e lartë, edhe

shkenca shihet si një veprimtari e zbrazët që përdoret vetëm në funksion të avancimit akademik, në vend se të prodhojë dije dhe të jetë në funksion të zgjidhjes së problemeve konkrete të shoqërisë e të ekonomisë. Rrjeshimisht, shkollimi në Kosovë nuk ofron doemos punësim e mirëqenie. Si rezultat i kësaj ndodh "ikja e trurit" nëpërmjet të emigrimit të rinisë në vendet evropiane.

Programi për Reforma Ekonomike 2022-2024 i përpiluar nga Qeveria e Kosovës e sheh si pengesë kryesore strukturore për zhvillimin ekonomik të Kosovës 'mospërputhjen e shkathtësive me nevojat e tregut të punës' dhe rrjedhimisht ka identifikuar si nevojë 'Nxitjen e punësimit të qëndrueshëm nëpërmjet përmirësimit të arsimit cilësor dhe lidhjes me nevojat e tregut të punës'. Sipas këtij dokumenti rreth 50% e kompanive raportojnë se edukimi i përgjithshëm nuk i përgatit studentët në mënyrë adekuate për vendin e punës - qoftë në drejtim të njohurive të përditësuara apo shkathtësive të buta. Në masën e dytë të propozuar për ta tejkaluar këtë pengesë Qeveria është zotuar për 'Ngritjen dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe profilizimin e institucioneve të arsimit të lartë'.

Programet e studimit në universitetet në Kosovë rëndom janë dizejnuar për të përshtatur orët e punës së profesorëve aktual dhe fare pak për tu përshtatur me kërkesat e tregut të punës, të shkencës apo shoqërisë. Shembulli më ilustrativ është që bankat kosovare kanë vazhduar të trajnojnë për dy dekada të diplomuarit në Banka dhe Financa para punësimit të tyre.

Duke pasur parasysh peshën shoqërore të studimit në universitete, këto të fundit do të jenë vendet kryesore ku studentët kosovar do të aftësohen për treg të punës, andaj është e nevojshme që të krijohen kushte akreditimi ku universitetet duhet të tregojnë lidhshmërinë e programit të studimit me tregun e punës, ose të paktën universitetet të cilat marrin fonde nga taksapaguesi ta bëjnë këtë gjë.

Është i nevojshëm një studim i thellë rreth mospërputhshmërisë së aftësive të fituara në universitete me nevojat e tregut të punës, meqenëse do të prodhojë të dhëna specifike dhe do të identifikojë zbraztësirat në të gjithë mekanizmat dhe grupet e përfshira (studentët, universitetet, kompanitë, AKA, MAShT).

Studentët

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Bachelor dhe Master në të gjitha universitetet publike në vitin akademik 2022/2023, është 40,485, në vitin akademik 2019/2020 ky numër ishte 68,533. Numri i studentëve të kolegjeve private për vitin akademik 2022/2023 është 30,952, në vitin akademik 2019/2020 ishte 35,987. Numri i studentëve në Kosovë në vitin akademik 2022/2023 i bie të jetë 3,969 për 100,000 banorë. Për krahasim, sipas të dhënave në Eurostat, numri i studentëve për 100,000 banorë në BE në vitin 2021 ishte 3,669.

Numri i stafit akademik për kokë studenti në universitetet publike në Kosovë i bie të jetë 30 studentë për 1 pjesëtar të stafit akademik. Për krahasim, mesatarja në BE është 11 studentë për 1 profesor, në Serbi 31 studentë për profesor dhe në Maqedoni të Veriut është 17 për 1.

Raporti i tanishëm hierarkik profesor – student është ndër dimensionet kryesore të kontekstit në arsimin e lartë. Në këtë relacion brengos statusi i studentëve si viktima të keqtrajtuara, në njërën anë, por edhe mungesa e përgjithshme e vetëdijes së studentëve përkitazi me të drejtat por edhe obligimet e tyre, në anën tjetër. Këtë terren më së miri e shfrytëzojnë organizatat studentore të cilat shtyjnë interesa të ngushta grupore apo partiake, duke tentuar t'i joshin studentët përmes disa çështjeve jo shumë relevante në Universitet siç është kërkesa për afate shtesë të provimeve, kërkesë kjo që nuk ndikon domosdo në studime kualitative, në ndërkohë duke injoruar çështje thelbësore si adresimi i duhur dhe rigoroz i ngacmimeve dhe keqtrajtimeve seksuale në Universitet, çështjet e avancimeve akademike jo meritore etj. Një situatë e këtillë ka rezultuar me riciklimin e pushtetit të profesorit nëpër gjenerata dhe me një ndjenjë të pafuqisë ndër studentët. ORCA duhet të angazhohet në fushën e të drejtave studentore që të

rimendohen mekanizmat kryesor siç janë protesta dhe kundërshtimi studentor, të rimendohet kalimi prej qëllimit për një diplomë në një vetëdije kritike që synon dhe kërkon cilësi tjetër të shkollimit, si dhe në fund, kalimi nga vetëdija kritike në vetëdije vepruese jo vetëm të organizatave të shoqërisë civile por edhe i organizatave studentore në mbrojtje të studentëve dhe të cilësisë në arsim.

Nxënësit e shkollave të mesme

Përveç studentëve edhe nxënësit e shkollave të mesme janë një kategori e rëndësishme që lidhen me arsimin e lartë. Testi PISA që teston nxënësit 15 vjeçarë është shumë i lidhur me cilësinë në arsimin e lartë. Nëse rezultatet thonë se 83% e tyre kanë dështuar në të lexuar, shanset që ata të përmirësohen në 2-3 vitet e ardhshme të shkollimit të mesëm i cili nuk e ka atë synim, janë tejet të vogla. Ardhja e atyre nxënësve si studentë në sistemin e arsimit të lartë pas pak vitesh përbën një sfidë për sistemin i cili nën presionin e uljes së vazhdueshme të numrit të studentëve në nivel vendi, bën vazhdimisht lëshime në kriteret e pranimit dhe si rrjedhojë rrezikon kompromet imin e cilësisë në nivele alarmante.

Në anën tjetër nxënësit në Kosovë kanë një energji të madhe veprimi e cila nuk arrin të çlirohet si pasojë e mungesës së aktiviteteve në shkollat e Kosovës të cilat përtej zhvillimit të lëndëve mësimore nuk i kushtojnë fare rëndësi aktiviteteve ekstra-kurrikulare.

Nxënësit e shkollave të mesme e në veçanti maturantët janë një kategori të cilën organizatat që merren me nxitjen e aktivizmit studentor, siç është ORCA, duhet t'i shohin si grup i targetuar potencial i aktiviteteve të tyre.

Liberalizimi i vizave

Heqja e vizave për qytetarët e Kosovës ka krijuar mundësi të reja kulturimi e arsimimi për të rinjtë e vendit. Një numër i konsiderueshëm e kanë më të lehtë gjetjen e vendeve të punës dhe krijimin e kontakteve për mundësitë e vazhdimit të studimeve jashtë vendit. Megjithatë, nuk është vërejtur ndonjë "eksod" i të rinjve siç trumpetohej para liberalizimit të vizave për Kosovën.

Mundësi të reja për organizim të aktiviteteve studimore e kulturore janë hapur për organizatat e shoqërisë civile që merren me kauzat rinore. ORCA do të eksplorojë mundësitë e promovimit të kulturës evropiane përmes organizimit të ekspeditave kulturore me studentë me qëllim të ngritjes kulturore e arsimore të tyre.

Shoqëria drejt diskutimeve të reja sipas trendeve globale

Heqja nga agjenda e temës së korrupsionit si temë kryesore e dominimit të diskursit publik, ka lënë vend për diskutime të tjera. Ekziston një tendencë e medieve që hapësirën ta mbushin me diskutime politike për dialogun me Serbinë, si dhe në disa mediume vërehet krijimi i hapësirës për emisione me karakter spikatjen e skandaleve apo edhe diskutimet për temat konspirative. Ka persona të caktuar të cilët ftohen rregullisht në skenën mediale e të cilët artikulojnë teori konspiracioni si për shembull forma e tokës, efektet e vaksinimit gjatë pandemisë, e të tjera të cilat në nivel global kanë zënë tashmë një vend të rëndësishëm në rrjetet sociale.

Mosangazhimi i të rinjve në aktivitete kulturore, arsimore, rekreacioni, sporti apo të tjera që do të mund të konsideroheshin universalisht përfituese për ta, i bën ata të cënueshëm ndaj "kauzave" konspirative dhe si rrjedhojë të keqpërdorshëm nga sulmet hibride gjatë kohës së zgjedhjeve.

Në anën tjetër, diskutime mbi të drejtat e komunitetit LGBTIQ+ çdo herë e më tepër po normalizohen në shoqërinë kosovare. Në Prishtinë për të tetën herë me radhë u organizua me sukses Parada e Krenarisë në një atmosferë festive. Ndonëse u përcoll me debate e diskutime të cilat u nxitën nga grupe

konservatore të shoqërisë, organizimi çdo herë e më festiv i paradës është tregues që shoqëria po bëhet më tolerante ndonëse jo miqësore apo përkrahëse ndaj komunitetit.

Çështja gjinore

Përbërja gjinore e stafit akademik të universiteteve publike të Kosovës tregon se 38.90% janë femra dhe 61.09% janë meshkuj, duke treguar një përqindje më të lartë të meshkujve. Nga ana tjetër, në universitetet publike të Kosovës, femrat përbëjnë shumicën e studentëve, me 64.93% studente femra dhe 35.06% meshkuj. Kjo tregon një prani më të madhe të femrave në mesin e studentëve, krahasuar me stafin akademik. Përgjatë viteve 2021-2023 ORCA ka realizuar 156 aktivitete me studentë. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 1396 vajza studente dhe 679 djem studentë.

Në Universitetin e Prishtinës diskutimi mbi ngacmimet seksuale ka marrë rëndësi në diskursin publik vetëm në vitin 2018 kur një prorektore fajësoi vajzat studente për veshjen e tyre kur po fliste për ngacmimet seksuale, çka u përcoll me një varg protestash që çua në shkarkimin e prorektores. Më pas Universiteti i Prishtinës krijoi një grup punues, i cili hartoi një rregullore për parandalimin e ngacmimeve seksuale. Me gjithë defektet që ka, ajo rregullore u pa si një hap i rëndësishëm i njohjes së fenomenit brenda institucionit.

Gjatë vitit 2023, 27 studente të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës bënë një denoncim të përbashkët kundër një profesori. Pas një prolongimi gati njëvjeçar të rastit nga ana e Këshillit të Etikës, pas mediatizimit të rastit dhe protestave të organizuara nga aktivistët që bllokonin hyrjen e rektoratit, u arrit suspendimi i të denoncuarit dhe çuarja e rastit edhe në prokurori si rast i veprës penale. Njëra nga studentet që foli hapur se ishte ngacmuar, gjatë protestës u pa duke buzëqeshur në një moment të vetëm dhe kjo pamje u përdor pastaj për denigrimin e saj në rrjete sociale. Diskutimi publik rreth çështjes filloi të dominohej nga ideja që denoncimi ishte i rrejshëm me qëllim njollosjen e profesorit duke shpërfillur faktin se këtë denoncim e kishin bërë 27 vetë dhe se dëshmitë e dhëna ishin vështirë të mohueshme.

Ky lloj i diskutimit në rrjete sociale ka marrë përmas shqetësuese. Një numër i madh të rinjsh vërshohen gjatë gjithë kohës me video dhe materiale tjera që pretendojnë se ekziston një konspiracion i mirëmenduar kundër burrave dhe burrërisë (manhood) dhe si rrjedhojë burrat duhen mbrojtur veten. Kjo "lëvizje" me karakter global ka mbërritur edhe në Kosovë përmes rrjeteve sociale. Nën këtë frymë janë krijuar grupe për denigrimin e grave siç ishte rrjeti në telegram "AlbKings" i cili shërbente si një hapësirë "e sigurtë" e burrave dhe djemve ku ndaheshin fotografi të vajzave dhe grave që përcilleshin me fyerje, shpifje e denigrime. Për publikun e gjerë ky grup prej më shumë se 100 mijë vetash që përbëhej kryesisht nga djem të rinj, u bë i ditur vetëm pas denoncimeve të gazetarëve dhe ndërhyrjes së prokurorisë dhe policisë që arritën ta identifikonin themeluesin e grupit dhe ta mbyllnin atë. Kjo tregoi që paralelisht me atë që dimë për zhvillimet diskursive në diskursin publik, në rrjete të ndryshme sociale janë krijuar oaza të diskutimeve për të cilat publiku i gjerë e sidomos gjenerata të caktuara mund të jenë të informuara për shkak të natyrës së rrjeteve që u dedikohen kryesisht të rinjve.

Krijimi paraprak i një ambienti ku normalizohet denigrimi i vajzave dhe grave pashmangshëm do të çojë te aktet siç mund të jenë sulmet seksuale, përdhunimet apo edhe vrasjet e grave. Disa ngjarje në vitet e fundit kanë tronditur publikun kur grupe burrash dhe djemsh ishin të përfshirë në përdhunim të minoreneve, apo kur gratë ishin viktima të femicidit nga bashkëshortët apo partnerët e tyre. Shprehja e tronditjes përmes protestave, reagimeve të figurave publike dhe përfaqësuesve të institucioneve si dhe diskutimeve në emisione televizive, sado që shënon një distancim formal të shoqërisë nga ngjarjet, mund të vërehet që një masë njerëzish shprehnin pandjeshmëri për viktimat nëpër seksionet e komenteve në rrjete sociale ku fajësonin viktimat përmes hamendësimeve të ndryshme.

Gjatë vitit 2024 në Kuvendin e Kosovës u diskutua për ligjin për shëndetin riprodhues, që do të mundësonte riprodhimin e individëve të pamartuar, pra grave që vendosin ta ndjekin procedurën. Për herë të parë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore kur e drejta e abortit dhe vetëvendosjes për trupin nga ana e grave ishte vendosur si standard edhe në Kosovë si pjesë e Jugosllavisë, filloi të vihej në pikëpyetje liria e grave për abort apo për të krijuar familje pa pasur partner mashkull prezent në familjen e krijuar.

Teoritë konspirative si mjet për rritjen e cënueshmërisë së të rinjve

Gjatë vitit 2024 në Kosovë filloi të "formalizohen" zërat e teorive konspirative që morën një hov të madh gjatë periudhës së pandemisë, konkretisht periudhës së vaksinimit. Tanimë ekzistojnë persona të njohur si figura publike që ftohen rregullisht në emisione për të artikuluar lloj lloj teorish konspirative si forma e tokës apo të tjera. Rëndom këto teori duken të padëmshme në kuptimin që ato shpeshherë nuk shtyejnë përpara një ide të caktuar. Mirëpo studimet tregojnë se personat që janë ushqyer me të tilla teori janë më të cënueshëm nga informacionet e rreme në kohë zgjedhjesh apo në situata tjera me rëndësi shoqërore. Është e rëndësishme që të rinjtë të kenë hapësira ku mund të kalojnë kohë kualitative të ngritjes kulturore e akademike pasi janë grupi më i cënueshëm nga teoritë e tilla dhe informacionet e pavërteta që shpërndahen pa kontroll në rrjete sociale.

Teknologjia

Prezantimi para publikut i ChatGPT nga OpenAI në fund të vitit 2022 gjeti të habitur një pjesë të madhe të publikut global. Hapja e një horizonti të ri përmes një mekanizmi komunikimi i cili mund të përdoret si asistent hulumtimi, asistent përpilimi tekstesh, asistent dizajnimi e shumë mundësi tjera, padyshim ka revolucionalizuar nëse jo veprimtaritë, atëherë mënyrën si ne mendojmë për to. Sot analizimi i tabelave apo teksteve dhe nxjerrja e thelbit nga to mund të bëhet me përpilimin e një pyetje apo komande që mund t'i bëhet chatbot-it. Përveç kësaj, një numër i madh programesh të dizajnimit, video editimit, photo editimit, integruan në teknologjitë ekzistuese mekanizmat të ngjashëm me ChatGPT të cilat një personi të patrajnuar në dizajn, fotografi apo videografi i mundësojnë krijimin e produkteve që më parë ishin të paimagjinuara të nxirreshin nga persona te pakualifikuar. Kjo ka krijuar mundësi të jashtëzakonshme të pavarësimit të entiteteve të ndryshme (përfshirë OJQ-të) nga të angazhuarit e kushtueshëm të profesionistëve të ndryshëm për krijimin e raporteve, nevojave të ndryshme të dizajnit grafik, video prodhimit e të tjera, dhe ka bërë që abonimet vjetore dhe trajnime që mund të ndiqen online të mund të zëvendësojnë zinxhirë të tërë të veprimit që mund të duheshin më parë për të nxjerrë një produkt (siç mund të jetë dizajnimi i raportit hulumtues, video grafikat, posterët etj.).

Automatizimi i proceseve hulumtuese, i përpunimit të të dhënave është bërë lehtë i mundshëm dhe i paevitueshëm në pak vite të ardhshme. Kjo përveç se është një mundësi, ajo mund të përbëjë edhe një sfidë në rast se organizata nuk arrin t'i adaptojë me kohë mundësitë e krijuara të cilat më vonë mund të shndërrohen në rreziqe dhe dobësi.

Digjitalizimi i informatave të mbledhura, strukturimi i tyre në të dhëna lehtë të përdorshme nga bot-ët e ndryshëm të programeve të ndryshme është një domosdoshmëri e kohës me qëllim të përgatitjes për fazën e re të automatizimit dhe robotizimit të proceseve që deri tash janë kryer në mënyrë "mekanike" si vjen fjala hulumtimi në tavolinë apo përpunimi "mekanik" i të dhënave të nxjerra nga hulumtimi.

Dilemat e reja etike në epokën e Inteligjencës Artificiale

Në botën akademike tashmë ka filluar diskutimi për standardet e reja të etikës në akademi, të cilën ORCA e ka përcjellë me kujdes. Me avancimin e teknologjive të cilat mund të përpilojnë tekste sipas kërkesave të përdoruesit të tyre, janë ngritur pyetje mbi atë se çka është autori në epokën e Inteligjencës Artificiale.

Deri më sot kishte standarde të ndryshme të aplikueshme që lejonin përdorimin e teksteve të tjera (gjithnjë duke i cituar dhe referencuar ato) në tekstet origjinale në vartësi të llojit të tekstit akademik. Në vitet e ardhshme është shumë e mundshme që autori çdo herë e më shumë do të jetë vetëm ideator, redaktor dhe garantues i cilësisë së një teksti të përpiluar nga Inteligjenca Artificiale. Kjo situatë e re hap një horizont të ri për organizata si ORCA të cilat janë pionere në shoqëritë përkatëse për adresimin e çështjeve të integritetit akademik, pasi ato mund të shndërrohen në agjentë të ri të promovimit të standardeve të reja dhe edukimit të publikimit për përdorimin etik të teknologjisë së fuqizuar nga Inteligjenca Artificiale.

Ambienti

Tranzicioni i gjelbërt është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Bankat zhvillimore kanë financuar dhe do të financojnë projekte të kushtueshme në gjenerim dhe ruajtje të energjisë së gjelbërt, dhe si rrjedhojë pritet të rritet nevoja për një fuqi punëtore adekuate për implementimin e projekteve. Me hapjen e investimeve të gjelbërta do të rritet eksponencialisht kërkesa për individë të kualifikuar në instalimin e paneleve solare dhe gjeneratorëve të erës, instalimit të baterive, menaxhimit të operacioneve në rrjetin elektrik, dhe zyrtar publik adekuat të cilët do të lehtësojnë marrjen e lejeve të nevojshme për këtë tranzicion. Fatkeqësisht Kosova nuk ka një plan efektiv të adresimit të mungesës së fuqisë punëtore në energji. Programet studimore në energji janë të mangëta dhe mezi arrijnë të akreditohen. Universitetet do të jenë akterët kryesor të aftësimit të fuqisë punëtore në energji dhe si të tillë do të ndikojnë direkt në tranzicion të gjelbërt.

Në veprimtarinë e brendshme, ndonëse ORCA nuk është një organizatë që ka në fushën e vet të veprimtarisë adresimin e çështjeve mjedisore, ajo ka integruar përgjegjësinë individuale të mbrojtjes së mjedisit. ORCA është kujdesur që në zgjedhjen e teknologjive që përdor të jenë të përfshira aspektet e mbrotjes së ambientit për shembull në përdorimin e gotave të letrës apo gotave të xhamit kur ishte e mundur me qëllim të evitimit të përdorimit të plastikës si një problem kyç i ndotjes së ambientit.

Me daljen e teknologjive të reja, ORCA ka shmangur shtypjen e raporteve me dhjetëra faqe dhe i ka zëvendësuar ato me bookmarks të cilat përmbajnë QR kodin i cili çon poseduesin te raporti i caktuar i ORCA-s.

Në grantëdhënie për grupe joformale studentore ORCA në thirrjet e publikuara ka inkurajuar projektet e studentëve të cilat mund të kishin për qëllim adresimin e çështjeve të ambientit.

Ligjorja

Ndryshimi i ligjeve në fushën e arsimit mund të jetë shumë i vështirë pasë parasysh situatën aktuale politike. Kjo për shkak se arsimi konsiderohet fushë me rëndësi vitale dhe sipas Kushtetutës dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë, për ndryshimin apo propozimin e ligjeve të reja në fushën e arsimit kërkon miratimin e shumicës së dyfishtë.

ORCA është pjesëmarrëse e rregullt në hartimin e dokumenteve të ndryshme rregulluese në nivel kombëtar, si ligjet, udhëzime administrative, rregullore e dokumente të tjera që nxjerrin institucionet publike të Kosovës. ORCA ndihmon me ekspertizën e vet në hartimin e tyre në fushën e integritetit akademik, rritjes së llogaridhënies dhe transparencës.

ORCA ka qenë subjekt i dy padive të bëra ndaj saj ose përfaqësuesve ligjor të saj si pasojë e angazhimit publik në parandalimin e shkeljeve të ndryshme që i janë kanosur proceseve të ndryshme në të cilat ORCA

ka qenë e përfshirë. ORCA këto i ka parë si formë e padive SLAPP ndonëse asnjë nga to deri sot nuk ka pasur sukses në asnjë nivel të drejtësisë kosovare.

Ligji aktual që rregullon çështjen e shpifjeve është në favor të OJQ-ve me nene eksplicite që mbrojnë OJQ-të edhe në rast se ato kanë gabuar duke shpërndarë informacion të pasaktë por që kanë qenë të bindura se po mbrojnë interesin publik. Megjithatë formulimi i varfër i neneve në fjalë dhe ligjit në përgjithësi e bënë të diskutueshme këtë mbrojtje e cila duhet argumentuar mirë në rast të ndonjë padie eventuale.

Amandamentimi i Ligjit për Zyrtarët publik i muajit prill të vitit 2022, kur me mocion për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, me propozim të LVV dhe me pajtim të partive tjera u ndryshua Neni 22, pika 6, i cili nuk lejonte që deputetët apo ministrat të ishin pjesë e procesit të avancimeve akademike në universitete publike. Ky ndryshim i shpejtë dhe pa diskutim publik, tregoi sa të cënueshme mund të jenë proceset e ndryshme nëse partitë kanë koncensus. Duke qenë se një numër i madh i politikanëve kanë afiliim me universitete publike, asnjë parti, përfshirë edhe ato opozitare nuk e kundërshtuan një amandamentim të tillë dhe kjo bëri që në një pasdite të vonë, me një votim super të shpejtë, diçka që ishte vendosur me vite të tëra të ndryshonte dhe ta hapte arsimin e lartë ndaj mundësive të kapjes politike. Duke qenë se kishte koncensus partiak në Kuvend, reagimet e ORCA-s nuk morën as vëmendjen e duhur nga mediat as nga publiku, por u panë si një zhurmë e paarasyeshme apo si një kritikë për hir të kritikës.

Statuti i ri i UP-së

Miratimi i tij nga Kuvendi (11 korrik 2024) shënon një fitore të diskursit të ORCA-s lidhur me publikimet dhe hulumtimet shkencore dhe kualitetin e revistave ku botohen punimet shkencore, me ç'rast avokimi disa vjeçar i ORCA-s bëhet pjesë e legjislacionit të vendit. Drejtori i ORCA-s në kuadër të koalicionit KITU ishte dërguar si anëtar në Komisionin e themeluar nga rektori i UP-së me qëllim të hartimit të draftit. ORCA pati mundësi të adresonte çështje me rëndësi për proceset akademike për të cilat ka avokuar për vite me radhë. Statuti i ri i UP-së, ndonëse nuk është në versionin që ORCA do të kishte dëshirë, meqë vendimet e komisionit merreshin me shumicë votash, ai përbën një kapërcim të madh të arsimit të lartë në vend drejt një etape të re të hulumtimit shkencor dhe publikimit akademik. Një aspekt tjetër i Statutit të ri është fleksibiliteti i tij dhe mundësia që universiteti t'i përshtatet nevojave të kohës, duke përcaktuar në një nen se kriteret akademike të vendosura në Statut vlejnë vetëm si kritere bazë mbi të cilat mund të ngrihen kritere të tjera më të avancuara.

Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Gjatë vitit 2023 Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim. ORCA ishte po ashtu pjesë e komisionit draftues të ligjit të emëruar nga Ministria e Arsimit e cila e draftoi atë. Miratimi i tij në Kuvend dhe tentativat e deputetëve për ta kompromentuar cilësinë e tij u luftuan nga ORCA përmes aksioneve simbolike dhe denoncimeve publike të cilat bënë që drafti fillestar i Komisionit draftues ku merrnin pjesë edhe ekspertë të ndryshëm të huaj e vendorë, të mos pësonte ndryshime signifikante.

Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe dokumentet rregulluese të saj janë një siguresë e rritjes së cilësisë në arsimin e lartë në vend. Pavarësisht kontestimit të platformave ranguese të revistave që mund ta bëjnë universitetet publike, pavarësisht miratimit të Statutit të ri të UP-së, rregullat aktuale të akreditimit janë dizajnuar në atë mënyrë që profesorët që nuk kanë punime shkencore të mjaftueshme nuk mund të jenë pjesë e procesit akreditues të programeve. Pra edhe sikur të lejohej punësimi apo avancimi akademik i profesorëve pa zbatuar kritere, ata do të jenë të papërdorshëm nga universitetet para komisioneve vlerësuese ndërkombëtare të akreditimit të cilat zbatojnë rregullativën e agjencisë që kërkon punime shkencore nga profesorët e përshirë në akreditim. Vërehet se disa universitete publike

gjatë procesit të avancimeve akademike në mënyrë diskrete zbatojnë kritere që dalin nga rregullativa e Agjencisë së Kosovës për Akreditim ndonëse në statutet e tyre kriteret mund të jenë më të ulëta.

Fusha e intervenimit: Hulumtimi dhe Monitorimi

Objektiva Strategjike 1: Të nxisë konkurrueshmërinë në arsimin e lartë përmes aktivitete hulumtuese dhe avokuese

Fuqizimi i hulumtimit me inteligjencë artificiale

Organizata ka për qëllim ta ndërrojë mënyrën e kryerjes së hulumtimeve duke integruar teknologjitë më të reja në procesin e hulumtimit. Mbledhjen e deritashme të informatave dhe përditësimit të tyre, që hulumtuesit në ORCA e kanë kryer përmes kërkimit manual, ORCA po angazhohet në ndërtimin e instrumenteve të automatizuara të mbledhjes së informacioneve (scratching) që tashmë gjejnë përdorim nga entitete të ndryshme.

Krijimi i Platformës për Rangimin Kombëtar të Universiteteve

Pas krijimit të një instrumenti që mbledhë informata të nevojshme për ORCA-n, puna që duhej kryer nga një hulumtues për 1 deri në 3 ditë për hulumtimin e punës shkencore të një anëtari të stafit akademik, reduktohet në jepjen e një komande dhe gjenerim të informacionit në pak minuta. Koha e kursyer në këtë drejtim do të bëjë që hulumtuesit të kenë kohë për qasje më holistike në temat e hulumtumit duke përfshirë intervistimin e të gjitha palëve, leximin e materialeve praktike dhe teorike që lidhen me hulumtimin përkatës dhe si rrjedhojë përpilimin dhe publikimin e raporteve me përmbajtje të thellë analitike, për dallim nga raportet e deritashme që kanë pasur karakter më shumë deskriptiv, ndërkohë që pjesa analitike ishte më shumë e nënkuptueshme për shkak të rezultateve shqetësuese që publikoheshin. Si rrjedhojë do të bëhet i mundshëm krijimi i Platformës për Rangimin Kombëtar të Universiteteve. Kjo do të jetë një platformë unike për dallim nga ato ekzistueset në të cilat rangohen universitetet e Kosovës pasit ato masin parametra që kanë të bëjnë me aspektet formale të qasshme në internet, ndërkohë që nuk marrin parasysh ambientin ku veprojnë institucionet e ranguara apo nevojat shoqërore të vendit ku veprojnë ato.

Publikimi i rezultateve të rangimit periodik të universiteteve dhe kolegjeve publike do të nxiste konkurencën mes tyre. Duke qenë se ato janë të mbështetura financiarsht nga fondet publike, kjo konkurencë nuk do të kishte një efekt negativ të rritjes së pandjeshmërisë sociale të tyre, siç mund të ndodh për shkak të luftës së kolegjeve private për të ulur kostot. Përkundrazi, rritja e efikasitetit të universiteteve dhe kolegjeve publike si një shtysë e konkurencës mes tyre, angazhimi për kontribut në komunitet dhe përfshirja e tyre në projekte hulumtimi do të përbënte kalimin në një stad tjetër të llogaridhënies ndaj parasë publike. Pra, konkurenca e nxitur në këtë rast nuk sjell efektet negative që ajo mund të sjell në tregun e lirë privat, pasi konkurenca në këtë rast është për cilësi dhe jo për profit.

Mbërritja në një pikë ku ORCA do të fitojë kohë për analizim më të thellë të situatës në arsimin e lartë në Kosovë dhe përmes krijimit të një paltforme rangimi e cila në mënyrë periodike rangon universitetet në bazë të performancës së tyre vjetore ose gjysëmvjetore, do ta ndërrojë dhe qasjen e ORCA-s në bërjen e presionit publik ndaj universiteteve për përmirësim të vazhdueshëm. ORCA kalon nga qasja reaktive (reagim emergjent) në atë afirmative (propozim i rrugës së zhvillimit), pra nga një organizatë që reagon në raste lëshimesh në baza ditore, në një organizatë që mat performancën, propozon hapat e përmirësimit në krahasim me konkurentët në fushë (universitetet dhe kolegjet publike mes vete) në baza periodike. Përmes rangimit ORCA indirekt propozon zgjidhje konkrete për universitetet publike në atë se ku duhet fokusuar për ta përmirësuar performancën e përgjithshme në mënyrë që universiteti përkatës

të rangohet më lartë. Kritika transformohet në përgëzim për universitetet që kanë rangim të lartë, ndërkaq si udhërrëfyes për përmirësim (kritikë indirekte) për ato që kanë rangim të ulët.

Raporti gjithpërfshirës: Enciklopedia e Arsimit të Lartë

ORCA planifikon që nga viti 2025 të fillojë përpilimin e një raporti ku do të përfshihet çdo e dhënë nga të gjitha publikimet që bëhen për arsimin e lartë në Kosovë si dhe çdo ngjarje që lidhet me arsimin e lartë, përfshirë vendimet apo veprimet e insitucioneve të arsimit të lartë apo për arsimin e lartë. Çdo fundvit të publikohet një raport ku do të mund të gjendet çdo informatë për arsimin e lartë. Ky publikim do t'i nidhmojë hulumtuesit, politikbërësit, stafin akademik, studentët dhe çdo të interesuar në informimin rreth të dhënave për arsimin e lartë e po ashtu ngjarjeve që shënojnë atë. Raporti do të ketë qasjen enciklopedike të përshkrimit të të dhënave, jepjes së burimit origjinal të tyre dhe përshkrimit të shkurtër të ngjarjeve të shoqëruara me vegëza që çojnë te informacione më të përgjithësuara të tyre.
Vet raporti do ta ndihmojë ORCA-n në punët e saj që kanë të bëjnë me Platformën e Rangimit Kombëtar të Universiteteve.

Monitorimi sistematik i të gjitha institucioneve të arsimit të lartë

ORCA do të vazhdojë të monitorojë të gjitha universitetet dhe kolegjet publike të arsimit të lartë në Kosovë në disa çështje: proceset akademike, me theks të veçantë proceset e avancimeve akademike; transparencën formale institucionale; trasnaprencën financiare; aktivitetin studentor (organet e ndryshme studentore). Po ashtu do të vazhdojë monitorimin e 1. Komisionit Parlamentar për Arsim; 2. Agjencisë së Kosovës për Akreditim; 3. Qendrën për Njohjen e Diplomave (NARIC) në kuadër të MAShT; 4. Mediat dhe rrjetet sociale përmes platformës LOOQME , ngjarjet kryesore të palëve të treta rreth arsimit të lartë.

Fusha e intervenimit: Aktivizmi, avokimi dhe rrjetëzimi

Objektiva Strategjike 2: Të rrisë demokracinë në arsimin e lartë përmes fuqizimit të studentëve si faktor garantues i qëndrueshmërisë së saj

Demokratizimi i arsimit të lartë është i mundur në saje të aktivizmit të shëndoshë të studentëve, në saje të reagimit të shpejtë për ngjarje dhe zhvillime me rëndësi për arsimin e lartë, në saje të avokimit strategjik (adresimi i plagjiaturave, intervenimet në infrastrukturën ligjore përmes pjesëmarrjes aktive në komisionet hartuese), në saje të trajnimit të vazhdueshëm të stafit dhe studentëve në përdorimin e teknologjive të reja si dhe në saje të rrjetëzimit të mëtutjeshëm kombëtar dhe rajonal.

Aktivizmi

ORCA identifikohet me aktivizmin e saj. Ajo shpeshherë shihet si organizatë aktiviste pasë parasysh aksionet ikonike të reagimit si rasti i arrestimit të aktivistëve të saj gjatë ekspozimit të plagjiaturave, apo përfshirjes në protestat e studentëve për çështje me rëndësi. ORCA bën përpjekje të vazhdueshme për nxitjen e aktivizmit te studentët qoftë duke dhënë shembull me veprimet e veta apo duke organizuar programe që nxisin vetëdijen kritike të nevojshme për inspirimin e aktivizmit te studentët.

Qendra e aktivizmit studentor

Qendra e Aktivizmit Studentor në ORCA e themeluar me programin EJA (2021-2023) ka treguar sukses duke bërë që numri i studentëve pjesëmarrës në aktivitetet e saj të jetë 2779. Organizimi i ngjarjeve me karakter të ndryshëm, nga ligjëratat, trajnimet, strehë e klubit të leximit e deri te konferencat për shtyp apo shfrytëzimi i saj për përgatitjen e aksioneve e protestave, e ka shndërruar atë në një pikë fokale kur përmendet aktivizmi studentor në Kosovë. Parapërgatitjet me diskutime dhe aktivitete që kulmonin me Kongreset e Aktivizmit Studentor ishin disa nga momentet kyçe të përdorimit të Qendrës së Aktivizmit Studentor për arritjen e qëllimit të saj.

Një nga aktivitetet e pavarura të Qendrës së Aktivizmit Studentor ishte edhe Shkolla Politike e Aktivizmit Studentor e cila u mbajt me pjesëmarrës të zgjedhur me një program të ngjeshur vizitash studimore, ligjëratash e diskutimesh të cilat u mbajtën gjatë një jave të ngjeshur me agjendë. Në fundin e saj me iniciativë të vet studentëve pjesëmarrës u krijua grupi joformal Klubi i Leximit ku studentët dhe stafi i ORCA-s mblidhen në baza të rregullta javore për të diskutuar literaturë të paracaktuar bashkërisht, kryesisht me përmbajtje nga fusha e filozofisë.

Grantet për studentë

Përgjatë viteve 2019 – 2021 dhe 2022 – 2025 ORCA ka zotuar 180,000 Euro si grante për studentë. Deri në qershor të vitit 2024 kur u finalizua përditësimi i të dhënave për këtë dokument, ORCA kishte dhënë 57 grante me vlerë 102,429 Euro për 42 grupe joformale studentore ku kishin marrë pjesë 349 vullnetarë dhe mbi 10,000 pjesëmarrës në aktivitetet e granteve. Natyra e granteve të dhëna përmes projekteve të mbështetura nga Agjencia Austriake për Zhvillim në Kosovë (ADA), përmes projektit QAINT dhe HEI25, përfshin pothuajse të gjithë dimensionet e jetës studentore duke mos përjashtuar as rekreacionin, kur disa studentë aplikuan me një projekt që lidhej me operën e parë të studentëve të Universitetit të Prishtinës, mbështetëse e të cilës u bë edhe ORCA përmes granteve për studentë.

Shpërndarja e granteve në shumicën e universiteteve dhe kolegjeve publike si dhe mundësia që u jepet studentëve të të gjitha universiteteve dhe kolegjeve publike bën që një frymë e aktivizmit të përcillet në nivel kombëtar dhe si e tillë të krijojë një realitet të ngjashëm të reagimit publik për kualitetin e arsimit në nivel kombëtar. Grupet joformale studentore që fitojnë grante rëndom janë edhe pjesëmarrëse të

Kongresit të Aktivizmit Studentor që për 4 vite me radhë u organizua nga ORCA dhe që shënon ngjarjen më të madhe të aktivizmit studentor në vend.

Kongresi i Aktivizmit Studentor

ORCA ka organizuar 4 Kongrese të Aktivizmit Studentor në mënyrë konsekuente që nga viti 2021 e mbështetur nga NED. Kongresi i Aktivizmit Studentor është një bashkim i studentëve aktivistë që shprehin vullnetin për pjesëmarrës si dhe përfaqësuesve formalë të trupave studentorë në universitete publike. Kongresi ka planin e vet të avokimit dhe organet e veta udhëheqëse. Roli i ORCA-s në organizimin e tij ka shkuar duke u zvogëluar nga një rol udhëheqës në një rol tërësisht logjistik në Kongresin e IV-të të Aktivizmit Studentor kur organet udhëheqëse të Kongresit të III-të udhëhoqën në tërësi Kongresin e IV-të. Kjo bëri që edhe gara për zgjedhjen e Sekretares së Përgjithshme të jetë më e ngushtë me rezultate si dhe përfshirjen më të madhe të studentëve gjatë procesit zgjedhor. Megjithë insistimin e ORCA-s që Kongresi të pavarësohet tërësisht nga ORCA, vërehet nevoja e mbështetjes logjistike dhe financiare e ORCA-s (pra gjetja e fondeve për realizimin e Kongresit) për shkak të mungesës së përvojës së studentëve dhe aftësive të tyre për ngritje fondesh.

Avokimi i suksesshëm i organeve të Kongresit

Kongresi i Aktivizmit Studentor pas zgjedhjes së Sekretares së Përgjithshme dhe anëtarëve të tjerë të Komitetit të Kongresit, miraton edhe Rezolutën vjetore të Kongresit e cila reflekton synimet e aktivistëve studentë që paraqiten gjatë punës njëditore të Kongresit. Organet e reja udhëheqëse, në javët vijuese menjëherë pas mbajtjes së Kongresit zhvillojnë vizita dhe tryeza me përfaqësues të institucioneve për të adresuar çështjet që ngriten në rezolutë. Të gjitha Kongreset me sukses kanë zhvilluar vizita institucionale që zakonisht fillojnë me avokatin e popullit, për të vazhduar me përfaqësues të universiteteve publike, me deputetë dhe me ministra e zëvendësministra të fushave përkatëse që lidhen me çështjet e adresuara në rezolutat vjetore të kongreseve.

Përfshirja rajonale në Kongresin e Aktivizmit Studentor

Kongresi i Aktivizmit Studentor për 3 vite me radhë ka pasur pjesëmarrje të studentëve dhe folësve nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Në Kongresit e IV-të të Aktivizmit Studentor përveç pjesëmarrësve tradicionalë nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria të cilët raportuan për situatën studentore në vendet e tyre, raportuan edhe aktivistët nga Mali i Zi dhe Serbia dhe kjo shënon herën e parë të pjesëmarrjes së aktivistëve nga të gjitha vendet me të cilat kufizohet Kosova në Kongresin e Aktivizmit Studentor në Kosovë.

Impakti i Kongresit në rajon

Forum for Educational Change në Maqedoni dhe Qëndresa Qytetare në Shqipëri si dy organizata partnere të ORCA-s, të inspiruara nga Kongresi i Aktivizmit Studentor në Kosovë kanë filluar mbajtjen e ngjarjeve të ngjashme në vendet respektive. Organizatat në fjalë gjatë aktiviteteve të tyre tregojnë për inspirimin nga Kongresi i Aktivizmit Studentor në Kosovë dhe e promovojnë tutje atë.

Avokimi

Nga raportet e gjata tek videot e shkurtëra

Kthimi i raporteve të gjata të organizatave të shoqërisë civile në video të shkurtëra informuese dhe posterë me përmbajtje shpjeguese grafike është i kushtueshëm për organizatat e shoqërisë civile që varen nga buxhete të limituara. Edhe në rast të gjetjes së fondeve, sasia e fondeve të nevojshme për të bërë video të shpeshta apo përmbajtje grafike të shpeshtë, do të ishte aq e madhe saqë do të përfshinte një pjesë jo të arsyeshme të buxhetit të organizatës.

ORCA ka trajnuar një pjesëtar të stafit gjatë vitit 2020 dhe tashmë shumicën e videove, përmbajtjeve grafike por edhe vet dizajnimin e faqosjen e raporteve e bën me mjete vetanake duke shfrytëzuar programet e reja të fuqizuara nga Inteligjenca Artificiale.

ORCA vetëm gjatë vitit 2023 ka prodhuar 17 video me 678 mijë shikime. Raportet e shkruara të saj që mund të jenë joatraktive për të rinjtë ORCA po i kthen në video të shkurtra shpjeguese ku jep disa nga të dhënat kryesore në formën e një ngacmimi që mund të çojë shikuesin drejt raportit të publikuar apo thjesht ta pajisë atë me informatat më të rëndësishme që lidhen me arsimin e lartë në vend.

Po ashtu, në politikën e saj të publikimeve ka adaptuar një logjikë të krijimit të grafeve shpjeguese edhe brenda raporteve që mund të përdoren si fotografi apo posterë në rrjetet sociale.

ORCA vazhdon edhe për një kohë ta përdor konferencën për shtyp si mjet për arritje në ballinat e mjeteve mainstream të informimit, jo për të mbërritur te publiku por si një mjet për të shënuar seriozitetin e çështjeve që ngritë. Fokusi kryesor i organizatës mbetet shtrirja e rrjeteve të saja sociale te një gamë e gjërë e popullsisë ashtuqë në të ardhmen e afërt të pavarësohet nga pavëmendja eventuale e mediave (që është e shprehur) për temat e arsimit apo keqkomunikimi i të dhënave nga mediat si pasojë e cilësisë së dobët të gazetarëve.

Aksionet simbolike si mjet për edukim

Avokimi përmes aksioneve simbolike për të ngritur çështje me rëndësi strategjike ose për emergjenca mbetet një mjet efikas i ORCA-s për të përcjellë te publiku ndjenjën e emergjencës apo rëndësisë jetike për ngjarje a procese të caktuara. Aksionet simbolike me karakter denoncues apo edhe përgëzues, sidomos me përmbajtje satirike çmohen nga publiku dhe feedback-u që merr ORCA në raste të tilla është gjithnjë pozitiv.

Pjesë e aksioneve simbolike janë shpeshherë edhe ankesat dhe denoncimet brenda institucioneve të arsimit siç ishin rastet e plagjiaturës, ngacmimeve seksuale, shkeljeve të tjera disiplinore. Ndonëse në jetën universitare mund të ketë shumë raste të tilla, ORCA duhet të vazhdojë që denoncimet e veta t'i ketë me një qasje strategjike duke zgjedhur raste që përfaqësojnë fenomene dhe po ashtu të jetë realiste në kapacitetet që gëzon për t'i çuar rastet e ngritura deri në fund, të cilat në disa raste kërkojnë vite të tëra të përcjelljes.

Teknologjitë e reja zëvendësojnë shërbimet e kushtueshme

Prodhimi medial vetanak përmes teknologjive të reja (me përfshirje të Inteligjencës Artificiale) është një rrugë që tashmë ORCA po e ndjekë me sukses. Nga viti në vit ORCA ka ulur shpenzimet e parapara për dizajn, faqosje dhe shtyp të raporteve duke i zëvendësuar ato me forma të tjera që mundësohen nga teknologjitë e reja. Ka më shumë se 1 vit që ORCA nuk shtyp më qindra ekzemplarë raportesh por i ka zëvendësuar ato me bookmark-s të cilat mbajnë QR code të raporteve përkatëse e të cilat dizajnohen nga stafi i brendshëm.

Prioritizim i përdorimit të rrjeteve sociale

Fuqizimi i mëtutjeshëm i të gjitha rrjeteve sociale dhe mirëmbajtja e rregullt e tyre është një orientim i ORCA-s në vitet e fundit. Krahas platformave Facebook dhe Instagram, që nga viti 2024 ORCA ka filluar të përdorë edhe platformën TikTok për të shpërndarë videot. E gjithë permbajtja në rrjetet sociale vetëm në vitin 2023 ka mbërrirë tek më shumë se gjysmë milioni njerëz, ndërsa faqja e facebook-ut i ka mbërrirë 85 mijë vizita, gati 3 herë më shume se ne vitin 2022 kur ky numër ishte 85 mijë. Që nga viti 2020 ORCA ka publikuar 70 video të cilat kanë arritur 1 milion e 402 mijë shikime. Prej tyre 60 janë të prodhuara in-house të cilat i kanë arritur 1 milion e 305 mijë shikime. Videot më të shikuara janë ato të vitit 2023 të cilat kanë arritur 678 mijë shikime.

Podcast për arsimin

ORCA posedon teknologji e cila duhet përforcuar për realizimin e një podcasti që i dedikohet arsimit. Megjithatë, pa një investim më të madh është e rrezikshme që të lansohet një instrument i tillë i cili ka nevojë për konsistencë.

Qendra e trajnimeve

Qendra e Aktivizmit Studentor ndonëse ka zhvilluar trajnime lidhur me shkrimin e artikujve gazetaresk apo jepjen e aftësive që lidhen me aktivitete të caktuara, apo dije të përgjithshme mbi aktivizmin dhe mjetet e tij, ajo mund të krijojë programe trajnimi për teknologjitë e reja dhe përdorimin etik të tyre. ORCA do të synojë trajnimin e stafit të saj në përdorim të teknologjive të reja me mbështetje nga Inteligjenca Artificiale në video editim, dizajnim, përdorim të instrumenteve përpiluese dhe mbi të gjitha përdorimin etik të tyre.

Fakti që sot instrumente të Inteligjencës Artificiale janë në gjendje të përpilojnë tekste apo të zhvillojnë raporte qoftë edhe analitike të të dhënave, citimi i drejtë i tyre, përfshirja e tyre në sqarimet metodologjike të hulumtimit dhe përpilimin të teksteve mbetet diçka e panjohur për publikun e gjerë. ORCA duhet t'i prijë publikut kosovar në përdorimin etik të instrumenteve tekstshkruese dhe për analizim të të dhënave.

RRJETËZIMI

Rrjetëzimi në nivel kombëtar

ORCA është pjesë e dy koalicioneve në nivel kombëtar: 1. KITU - Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitete (2019 vazhdon) si dhe 2. ROSCAP - Rrjeti i Organizatave të Shoqërisë Civile për Arsim Parauniversitar (2024 vazhdon). Pranimi i ORCA-s në ROSCAP në vitin 2024 u bë me qëllim të shtrirjes së punës së ORCA-s edhe te nxënësit e shkollave të mesme konkretisht maturantëve.

ORCA është pjesë e organizatave që po mbledhin nënshkrimet për Peticionin për Shpëtimin e Arsimit i cili konsiston në nismë ligjore që ka kërkesa të caktuara. Organizatat pjesëmarrëse të ROSCAP në një ndërmarrje të përbashkët po përpiqen t'i mbledhin 10 mijë nënshkrime deri në vjeshtën e vitit 2024 për ta bërë të dërgueshme në Kuvend iniciativën qytetare. Kjo formë u pa nga organizatat si një mjet i mirë për angazhimin e qytetarëve në kauzat e tyre me qëllim të ngritjes së vetëdijes për rëndësinë që ka arsimi dhe reformat që duhen ndërmarrë në të.

Solidariteti - Reagimi i përbashkët me organizata të shoqërisë civile

ORCA ka nënshkruar dhjetëra letra publike e iniciativa të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile adresuar institucioneve vendore e ndërkombëtare. Po ashtu ORCA ka inicuar letra publike që u janë drejtuar institucioneve publike në disa raste kur ka pasur tendenca për ndërhyrje politike në universitete apo kur ka pasur neglizhencë në trajtimin meritor të rasteve të plagjiaturave.

Rrjetëzimi në nivel rajonal

ORCA ka një bashkëpunim joformal me organizatën Qëndresa Qytetare nga Shqipëria me të cilën ka bashkëorganizuar aktivitete dhe aksione protestuese. Ndërkohë merr pjesë dhe ftonë pjesëmarrës në aktivitete që organizatat bëjnë në vendet respektive.

Po ashtu ORCA ka filluar një bashkëpunim me organizatën HERA nga Maqedonia e Veriut me të cilën është bashkëaplikuese në një projekt me karakter rajonal si një përpjekje për shtrirjen e bashkëpunimeve me organizata të shoqërisë civile në vendet fqinje të Kosovës.

ORCA po ashtu ka marrë pjesë dhe ka ftuar në aktivitete të ndryshme aktivistë nga Forum for Educational Change (FECH) dhe Youth Educational Forum (YEF) si dhe Parlamentin Studentor në Universitetin Shën Krili dhe Metodi në Shkup.

Bashkëpunimi me Shqipërinë dhe Maqedoninë e veriut mbetet pikë fokale e bashkëpunimit rajonal për ORCA-n për shkak të ngjashmërive në sfida dhe sisteme të arsimit të lartë me vendet përkatëse, ndërkohë që përfshirja e Malit të Zi dhe Serbisë do të jetë vlerë e shtuar në aktivitetet e ORCA-s.

Fusha e Intervenimit: Adaptimi me teknologjitë e reja

Objektiva Strategjike 3: Të implementojë teknologjitë më të reja të mbështetura nga inteligjenca artificiale në avokim dhe komunikim me publikun.

Integrimi i teknologjive më të fundit si dhe inteligjencës Artificiale (IA) në çdo proces të hulumtimit, monitorimit dhe raportimit bëhet synim i ORCA në transformimin e saj teknologjik deri në vitin 2030. Në vitin e parë të zbatimit të këtij dokumenti strategjik ORCA do të fillojë me parapagimin e programeve që mundësojnë këtë transformim teknologjik.

ORCA ka zhvilluar një analizë të instrumenteve të domosdoshme për ta transformuar atë në një organizatë të vetmjaftueshme dhe të vetqëndrueshme kur vjen fjala te i gjithë procesi i hulumtimit e deri te publikimi i produktit final.

Për të arritur këtë objektivë ORCA parasheh blerjen në qasje në programet e ndryshme.

ChatGPT - Asistent virtual i fuqizuar nga Inteligjenca Artificiale (IA) i cili përdoret për analizë të të dhënave, asistim në shkrim, gjenerim i imazheve/fotografive/dizajneve. ORCA do e përdorë si asistim për analiza sipërfaqësore ad-hoc për qëllim marrje të informatave bazë, si dhe për gjenerim të imazheve për përdorim në rrjete sociale.

Adobe Creative Cloud All Apps - Pako me më shumë se 20 aplikacione dhe shërbimeve kreative, përfshirë Photoshop - editim të imazheve, Premiere Pro - krijim/editim të videove, After Effects - krijim të animacioneve, Acrobat Pro - krijim/editim të PDF, Adobe Firefly - model i fuqizuar nga Inteligjenca Artificiale për gjenerim të dizajneve/imazheve. Këto aplikacione janë themelore për punën e dizajnit grafik dhe prodhimit të videove dhe shumë të rëndësishme në aspektin e komunikimit me publikun.

Envato Elements - Platformë për shkarkimin pa limit të fotografive, grafikave, muzikës, 'templates', etj. të cilat përdoren në prodhimin e videove, dizajneve dhe animacioneve. ORCA do i përdorë këto materiale në prodhimin e videove.

Canva - Platformë e dizajnit grafik që përmban mjete për krijimin e grafikave për rrjete sociale, prezantimeve dhe materialeve promovuese, tashmë e fuqizuar dhe me IA.

Visme - Platformë e fuqizuar nga IA për dizajnimin e dokumenteve, raporteve dhe prezantimeve, dhe vizualizim të të dhënave. Kjo platformë do të përdoret nga ORCA për dizajnim të raporteve dhe materialeve promovuese.

Në tabelën e mëposhtme gjenden detajet e planifikimeve për blerje të programeve të sipërpërmendura.

		Tipi	Plani i pagesës	Muaji	Viti
1	ChatGPT 4	Plus	Mujore	€ 18.34	€ 220.08
2	Adobe Creative Cloud All Apps	Individual (max 2 kompjuterë)	Vjetore		€ 1,200.00
3	Envato elements	Individual	Vjetore		€ 182.00
4	Canva	Pro	Vjetore		€ 110.00
5	Visme	Starter	Mujore	€ 27.00	€ 324.00
			Vjetore		€ 136.00

Fusha e intervenimit; Menaxhimi, procedurat dhe qëndrueshmëria e organizatës

Objektiva Strategjike 4: Të avancojë procedurat që sigurojnë menaxhim efikas të proceseve dhe të resurseve të organizatës si dhe të rrisë kapacitetet e veta me qëllim të sigurimit të një financimi të qëndrueshëm të organizatës.

Si një organizatë joqeveritare, është me rëndësi substanciale që ORCA të ruaj pavarësinë e vet vepruese dhe frymën aktiviste. Në kushtet kosovare nuk është e lehtë të realizohet një gjë e tillë për shkak të mungesës së fondeve si për nga sasia dhe nga diversiteti i burimeve. Me fjalë të tjera, varësia nga fondet qeveritare mund të ndikojë në pavarësinë e veprimit të organizatës, siç është dëshmuar me rastin e OJQ-ve të shumta në fushën e rinisë, kulturës e të tjera. Rrjedhimisht, ORCA ka identifikuar strategji të ndryshme për të siguruar qasje në fonde por pa bërë kompromise me vlerat dhe parimet e veta. Në radhë të parë, kjo do të arrihet nga konkurrimi për fonde ndërkombëtare, krijimit të fondeve për aktivizëm studentor, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për mbledhje të fondeve e të tjera.

ORCA do të përcjellë me vëmendje thirrjet për projekte në fushën e veprimit të organizatës që shpallen nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë (ambasadat, agjencitë nacionale për zhvillim, kompanitë e ndryshme e të tjera). Në rast se nuk rrezikohet pavarësia e veprimit të organizatës karshi autoriteteve, ORCA do të konkurrojë edhe për fonde vendore. Para çdo konkurrimi të tillë, ORCA do të bëjë vlerësimin e rrezikut për rënien në ndikim të autoriteteve vendore dhe humbjen e frymës së aktivizmit studentor.

Llogaridhënia dhe transparenca nuk janë vetëm gjëra që organizatat e shoqërisë civile duhet t'i kërkojnë nga institucionet publike. Ato duhet edhe vet të japin shembull të realizimit të këtyre nocioneve të cilat janë një sfidë për jetën publike në Kosovë. Shumica e organizatave të shoqërisë civile kalojnë nëpër auditime dhe kontrolle rigoroze financiare nga donatorët e tyre, por kjo nuk është e ditur për publikun kosovar. Si rrjedhojë publiku kosovar i sheh me një sy dyshues OJQ-të për të cilat ekziston përshtypja e gabuar se "flenë mbi para" apo se udhëheqësit e tyre paguhen me shuma marramendëse (edhepse kjo mund të ishte e vërtetë në disa pak raste). Prandaj organizatat e shoqërisë civile duhet të tregohen të kujdesshme në të qenët llogaridhënëse dhe transparente për punën dhe parat që harxhojnë anipse në shumicën e rasteve ato nuk janë para të taksapaguesve kosovar.

ORCA kampion i transparencës

Publikimi eventual në ueb faqe përkatëse të organizatave i raporteve komplekse të auditimeve institucionale apo edhe të projekteve të audituara nga auditor të jashtëm, ndonëse është i nevojshëm dhe i mirëpritur, publiku i gjerë nuk arrinë të informohet për aktivitetin e organizatës dhe shpenzimet që ka bërë ajo për veprimtarinë e vet. ORCA pasi ka bërë një gjë të tillë ka vendosur që për çdo raport të saj të auditimit të bëjë video informuese që tregojnë lartësinë e pagave, llojet e aktiviteteve, donatorët dhe veprimtarinë e detajuar të organizatës. ORCA ka parë një interesim të madh të publikut në video të tilla. Në 3 video të publikuara nga ORCA dhe stafi i saj lidhur me llogaridhënien për fondet dhe veprimtarinë e saj, numri i njerëzve të arritur nga postimet është 109 mijë, i reagimeve dhe pëlqimeve 2,213 dhe numri i shikimeve 143 mijë. Kjo tregon se publiku ka interesim të dijë mbi të tilla të dhëna dhe kjo në afat të mesëm dhe të gjatë do ta përmirësojë imazhin e organizatës. ORCA për dallim nga orgnaizatat tjera nuk mjaftohet me vendosjen e informatave për aktivitetet dhe financat e saj në ueb faqen e vet, por angazhohet dhe shpenzon për informimin e publikut lidhur me llogaridhënien e vet dhe transparencën e vet financiare. Kjo duhet të mbetet qasja e organizatës edhe në vitet në vazhdim.

Menaxhimi dhe procedurat

Të gjitha dokumentet rregulluese të ORCA-s dalin nga Statuti dhe Organogrami. ORCA ka 11 dokumente rregulluese si rregullore, manuale dhe udhëzues për çështje të ndryshme, nga ato që rregullojnë Kuvendin e Anëtarëve deri te rregulloret financiare e Kodi Etik i punonjësve. Ka 6 vendime të Kuvendit të Anëtarëve që dalin nga mbledhjet vjetore të Kuvendit dhe Bordit. ORCA ka 2 dokumente strategjike, Dokumentin Strategjik 2020-2025 dhe këtë Dokument Strategjik 2025-2029. Nuk vërehet mungesa e ndonjë rregulloreje, por ORCA duhet të shohë mundësinë e digjitalizimit të procesit të caktimit të detyrave dhe raportimit për to.

Avancimi i mëtutjeshëm i raportimit intern nga stafi, pa shkaktuar ngarkesa burokratike

Ndonëse nuk ka pasur ndonjë efekt negativ në veprimtarinë dhe mirëvajtjen e punëve, ORCA nuk ka një formë standarde të shkruar të raportimit të secilit aktivitet të stafit të vet. Raportimi dhe diskutimi mbi punët zhvillohet në mbledhjet javore që kanë një karakter gjysmë-formal. Mbajtja e shënimeve të strukturuara është synim i ORCA-s në vitet në vazhdim. Një prakikë të re ORCA ka filluar ta ndjekë me komunikimin me email në mënyrë telegrafike të detyrave të ndara dhe punëve të raportuara si një mjet i memories institucionale të organizatës. Stafi i ORCA-s duhet të synojë strukturimin dhe formalizimin e mëtutjeshëm të kësaj praktike pa rrezikuar lëshimin në burokraci që ngulfasin atmosferën e mirë të punës në hapësirat e saj. Forma e administrimit të këtij procesi duhet të jetë digjitale. ORCA është e njohur me disa platforma digjitale që ofrojnë shërbime të tilla, por duke qenë një staf relativisht i vogël që nuk e kalon numrin 8, ndarja e detyrave dhe raportimi për to si dhe memorizimi i tyre nuk është një sfidë që kërkon forma burokratike e formale të kontrollit.

Qëndrueshmëria financiare

Identifikimi i donatorëve potencial, e veçanërisht donatorëve të cilët trajtojnë arsimin e lartë, duke analizuar dhe vlerësuar planet dhe strategjitë e tyre afatgjata.

Avokimi paraprak i interesave të ORCA-s përmes prezantimeve të rregullta nëpër debate publike. Intensifikimi i takimeve me donatorë të ndryshëm me qëllim të parashtrimit të kërkesave për rritjen e fondeve. Pos kësaj, do të shikohen metoda tjera të burimeve financiare pervec granteve. Do të shikohen edhe mundesite e konkurrimit për grante qeveritare dhe për bashkëpunim me sektorin privat meqë politikat e donatorëve janë duke ndryshuar. ORCA do të orientohet kah diversifikimi i burimeve financiare.

Për këtë qëllim ORCA do të identifikojë temat dhe problemet relevante në arsimin e lartë që do të trajtohen nëpërmjet të projekteve konkrete. Pastaj do të ngriten më tej kapacitetet e personelit për hartim të projekteve, si dhe, në raste të caktuara do të angazhohen konsulentë me ekspertizë të veçantë për hartimin e projekt propozimeve. Ngritja e kapaciteteve dhe hartimi i projekteve nga personeli do të bëhen njëkohësisht në punëtoritë që do të angazhohen për këtë qëllim.

Aavancimi i stafit

Deri më tash ORCA ka ndjekë një politikë të brendshme të lehtësimit sa më të madh të jetës së përditshme për stafin e vet. ORCA është nisur nga ideja që lumturia dhe mirëqenia individuale e secilit anëtar të saj do të çojë në produktivitet më të madh, më kualitativ në ORCA. Si rrjedhojë toleranca ndaj kërkesave për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme që nuk lidhen drejtpërdrejtë me punën e ORCA-s apo vizitat e ndryshme, ORCA i ka parë nën këtë prizmë dhe i ka miratuar si të tilla.

Në dy raste ORCA ka paguar shuma të konsiderueshme për të avancuar aftësitë e stafit të vet. Një anëtar i ORCA-s është trajnuar për multimedia dhe kjo ka rezultuar një sukses i jashtëzakonshëm. Pagesa prej rreth 1500 Euro për shkollën 6 mujore multimediale ka rezultuar në produkte mediale me vlerë prej

dhjetëra mijëra eurosh në rreth dy vite punë. Njejtë është vepruar edhe me ndihmën në pagesë të shkollës së kontabilitetit dhe auditimit SCAAK për të cilën është mbështetur një zyrtare e financave.

ORCA duhet të shoh mundësinë e trajnimit të stafit të vet në çështje të edukimit medial për të qenë lehtë e adaptueshme në rrethanat e reja teknologjike dhe në stilin e adaptuar së fundi nga vet ajo të transformimit të raporteve hulumtuese në video e posterë shpjegues. Këtë e lehtëson në masë të madhe integrimi i Inteligjencës Artificiale në shumicën e programeve që prodhojnë produkte të tilla, çka i mundëson edhe personave të patrajnuar thellësisht në çështje të video prodhimit, editimit apo dizajnimit të posterëve, të nxjerrin produkte dinjitoze të paraqitshme për publikun.

Plani i zbatimit dhe buxhetit

Plani i zbatimit dhe buxheti, përfshijnë gjithë periudhën e zbatimit të Planit Zhvillimor të ORCA-s për vitet 2025-2027 (pa përfshirë shpenzimet për personelin). Kostoja totale e zbatimit të planit zhvillimor për periudhën 2025-2027 është vlerësuar të jetë 673,656 €. Si plani i zbatimit, ashtu edhe planifikimi i buxhetit brenda periudhës së planifikuar, janë orientues dhe në parim kërkojnë të rishikohen në baza vjetore. Pjesa më e madhe e shpenzimeve të buxhetit për realizimin e planit janë paraparë të jenë nga mjetet e donatorëve të gjeneruara nëpërmjet të projekteve dhe granteve të ndryshme.

Para fillimit të çdo viti fiskal, ORCA duhet të analizojë me kujdes fondet në dispozicion nga projekte të ndryshme, nga mjetet e gjeneruara nga aktivitetet e ndryshme dhe nga donatorët të tjerë, me qëllim që të sigurohet financim i qëndrueshëm i veprimtarisë së organizatës.

Tabela në vijim, prezanton përmbledhjen e buxhetit të nevojshëm për realizimin e planit, sipas fushave të intervenimit.

Fusha e intervenimit	**Buxheti për fushë**
Hulumtimi dhe monitorimi	306,150
Aktivizmi, avokimi dhe rrejtëzimi	257,400 €
Adaptimi me teknologjitë e reja	14,830 €
Menaxhimi, procedurat, qëndrueshmëria financiare	95,276 €
Gjithsejt për vit	**673,656 €**

Masat e parapara në këtë plan janë të gjitha të karakterit zhvillimor dhe **nuk përfshijnë shpenzimet e pagave**. Shpenzimet kryesore të planit janë investimet në aktivitete hulumtuese, monitoruese dhe zhvillimore me karakter programor (për avancimin e shërbimeve të arsimit të lartë sipas prioriteteve të vendosura), si dhe në veçanti, masat për përkrahjen e aktiviteteve studentore.

Plani parasheh që gjatë tri viteve të ardhshme të Planit të rishikuar, ORCA duhet të sigurojë rreth 224,552€ në vit nga burime të ndryshme për të mundësuar realizimin e aktiviteteve të parapara në këtë plan. Një shumë e tillë nuk paraqitet e pamundshme nëse merren para sysh suksesi i ORCA-s në zbatimin e pjesës së parë të planit (2020-2024), imazhi pozitiv në komunitetin akademik, si dhe projektet e suksesshme në disa vitet e fundit. Investimet në infrastrukturë paraqesin një pjesë të vogël të shpenzimeve vjetore (kryesisht për sigurimin e objektit për Qendrën e Aktivizmit Studentore). Pjesa kryesore e shpenzimeve parashihet për aktivitetet hulumtuese, monitoruese dhe raportuese, si dhe në aktivitete të ndryshme me organizatat studentore, organizatat simotra dhe për rrjetëzimet rajonale. Pjesa e mbetur parashihet për zhvillimin e organizatës, përfshirë rregulloret e procedurat e ndryshme, për zhvillimin e personelit të ORCA-s, dhe për sigurimin e qëndrueshmërisë financiare. Struktura e shpenzimeve të parapara të këtij plani reflekton edhe prioritetet zhvillimore të ORCA-s në periudhën e planifikuar pas rishikimit, që janë hulumtimi, avokimi, komunikimi, pastaj aktivitete me komunitetin akademik (fryma aktiviste), hartimin e projekteve për aplikim për fonde të donatorëve, e të tjera. Këto janë plotësisht në koherencë edhe me misionin e vizionin e organizatës të shprehura në krye të këtij plani.

Në shtojcën 2 të këtij dokumenti janë prezantuar detajet e planit të veprimit dhe të buxhetit, përfshirë aktivitetet sipas masave, treguesit për aktivitetet sipas masave, periudha e zbatimit, përgjegjësitë, përshkrimi i buxhetit dhe ndarja e buxhetit në vite.

Korniza për vlerësimin e performancës

Një zyrtar i ORCA-s do të angazhohet drejtpërsëdrejti për monitorimin e zbatimit dhe informimin e menaxhmentit, respektivisht donatorëve, autoriteteve, partnerëve e të opinionit për procesin e zbatimit të planit. ORCA të organizojë mbledhjen e rregullt të informatave dhe raportimin vjetor lidhur me cilësinë e zbatimit të Planit, si dhe do të informojë palët e interesit lidhur me këtë. Për këtë qëllim janë identifikuar një listë e treguesve që do të shërbejnë si referenca për përcjelljen e zbatimit të Planit. Kjo listë përfshinë aspektet kryesore të strategjisë, si për shembull, rregulloret, raportet nga hulumtimet, publikimet e ndryshme, marrëveshjet e bashkëpunimit, programet e aftësimit të personelit e të tjera. Personeli i ORCA-s me ndihmën e ekspertizës së jashtme do të hartojnë dhe zbatojnë një Kornizë për Monitorimin e zbatimit të Planit për të matur zbatimin e masave strategjike të planit, relevancën, dhe ndikimin e masave të planit.

Indikatori	**Aktualisht**	**2025**	**2027**
Numri i personelit	8	8	8
Numri i organizatave partnere	21	23	23
Numri i projekteve – ongoing	1	3	3
Numri i projekteve – completed	28	30	32
Numri i trajnimeve për përfituesit	58	61	67
Të hyrat që nga themelimi i organizatës	1,541,246	1,765,798 €	2,214,902 €
Numri i studentëve të përfshirë në aktivitete	4,511	5,200	6,500
Numri i profesorëve hulumtuar	~1000	~1500	~2000
Numri i raporteve të publikuara	36	40	46
Numri i rregulloreve e procedurave	11	11	11
Hapësira m2	250	250	250
Numri i trajnimeve për personelin	6	10	15
Numri i udhëtimeve studimore	10	15	20
Nr. i kurseve formale vijuar nga personelit	3	5	8

Korniza për vlerësimin e rrezikut

Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor të ORCA-s, grupet punuese janë angazhuar edhe për vlerësimin e rreziqeve të ndryshme, faktorë kryesisht jashtë kontrollit të organizatës – që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e suksesshëm të Planit. Identifikimi i rreziqeve u bë gjatë analizës SWOT, ashtu edhe gjatë hartimit të masave dhe aktiviteteve për realizimin e objektivave të planit. Rreziqet janë analizuar pa një renditje të caktuar, duke analizuar shkallën e probabilitetit dhe shkallën e mundshme të ndikimit në zbatimin e masave të planit. Siç do të shihet në tabelën në vijim, shumica e rreziqeve të zbatimit të këtij Plani lidhen me autoritetet shtetërore, me përfituesit e shërbimeve të ORCA-s, mungesa e ekspertizës (për shkak të profilit relativisht të specializuar të ORCA-s) e të tjera. Në fund, shkurtimisht janë menduar edhe strategjitë e ndryshme për parandalimin, zvogëlimin e efektit negativ ose për tejkalimin e rrezikut. Në vijim janë rreziqet kryesore dhe analiza e tyre.

Rreziqet – çfarë të shmanget!	Prioriteti 1-5	Probabiliteti 1-3	Ndikimi 1-3	Masat / strategjitë parandaluese
Sulmet mediatike ndaj ORCA-s	3	2	1	Rritja e transparencës në raport me financat dhe aktivitetet
Ndërhyrjet politike nga Qeveria	5	3	2	Informimi i publikut dhe perdorimi i aksioneve simbolike për parandalimin e tyre.
Mungesa e fondeve	3	1	3	Ngritja e kapaciteteve për mbledhjen e fondeve; avancimi i raporteve me komunitetin akademik e me donatorë; avancimi i profilit specifik të ORCA-s; forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.
Qarkullimi i personelit	4	1	2	Motivimi i personelit; investimi në zhvillimin e personelit. Krijimi i mekanizmave për bartje të informatave sipas një tranzicioni të butë të onboarding dhe offboarding.
Mundësia e konfliktit të armatosur ose politik në nivel qendror	3	2	3	Komunikimi me donatorë për shtyerjen e afateve të zbatimit të projekteve dhe pezullimin e tyre.
Paqëndrueshmëria ekonomike globale si pasojë e konflikteve në rritje	2	2	2	Krijimi i hapësirave buxhetore përmes linjave të paparashikueshme aq sa është e lejueshme në projekte të veçanta.

Shtojca 1: Analiza SWOT

STRENGTHS (FUQI)	WEAKNESSES (DOBËSI)
• Profesionalizmi si parim i punës • Përvoja 7 vjeçare në arsim të lartë • Transparenca financiare • Aftësi komplementare të stafit • Reputacioni autoritativ në komunitetin akademik • Qasje e hapur për bashkëpunim • Përdorimi i teknologjive të reja në kryerjen e punëve • Adresë e palëve për ankesa dhe kërkim ndihme • Infrastrukturë e kënaqshme hapësinore dhe teknologjike • Aftësi të reagimit të shpejtë • Integriteti • Komunikimi me Publikun • Guximi për veprim proporcional • Kreativiteti në aksione • Njohja e kontekstit socio-politik dhe fushës së veprimtarisë • Rrjetëzimi me organizata dhe koalicione tjera • Aktivizmi i ekipit • Përvoja e gjatë në ORCA e shumicës së stafit (mobilitet i ulët i stafit) • Kolegialitet i shëndoshë • Mungesa e formalitetit në kryerjen e detyrave të përditshme • Pjesëmarrja e stafit në diskutim për vendimmarrje të rëndësishme • Të menduarit jashtë kornizave të projekteve ekzistuese • Qëndrueshmëri fianciare afatmesme	• Mungesa e burokracisë si mjet për siguri në procese • Devijimi nga plani i punës për shkak të intervenimeve ad-hoc • Disbalanc i përdorimit të rrjeteve sociale (fokusi në FB dhe instagram, të tjerat lënë anash) • Mungesa e raportimeve të shkruara formale të rregullta nga stafi (raportimet 1 mujore me shkrim) • Fokusi i ulët në ngritje të fondeve • Qasja josistematike në trajtimin e ankesave dhe palëve që e shohin ORCA-n adresë për ndihmë • Mungesa e prezantimit të punëve të stafit para kolektivit • Mungesa e procedurave të onboarding dhe offboarding • Mungesa e dixhitalizimit të të dhënave (dokumenteve të deponuara në ORCA ose në institucione tjera nga ORCA) • Mos standardizimi i të dhënave në një databazë të mirëstrukturuar
OPPORTUNITIES (MUNDËSI)	**THREATS (KËRCËNIM)**
• Vëmendje të mjaftushme publike për arsimin e lartë • Mungesa e organizatave të profilizume në arsimin e lartë • Prokrastinimi si rezultat i ambientit shoqëror në zyrë • Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e dokumenteve rregulluese në Kosovë • Interesimi i dontatorëve specifik në mbështetjen e organizatave të profilizuara • Vëmendja ndërkombëtare në proceset demokratike në Kosovë	• Qëndrueshmëri e munguar financiare afatgjate • Ekspozimi i rregullt në emisione televizive i stafit të ORCA-s • Sulmet e organizuara përmes denoncimeve të pabaza te donatorët • Paditë SLAPP • Sanskione ndaj Kosovës prej BE dhe donatorëve të tjerë • Sulmet mediatike ndaj ORCA-s • Mundësia e konfliktit të armatosur ose politik në nivel qendror

• Orientimi antikorrupsion i publikut • Stabiliteti qeveritar • Disponueshmëria e instrumenteve të Inteligjencës Artificiale në rritje • Disponueshmëria e kanaleve të larmishme për komunikim masiv • Gatishmëria e institucioneve, organizatave të shoqëriscë civile dhe bizneseve për bashkëpunim • Mundësia për aplikim në fonde që synojnë fusha jodosdoshmërisht të lidhura me arsimin e lartë • Mungesa e një platofrme kombëtare të rangimit të IAL-vë • Ekzistimi i platformave online për ngritjen e fondeve • Disponimi rajonal për bashkëpunim • Proceset e integrimeve evropiane • Frika e institucioneve dhe personelit akademik prej turpërimit publik • Imazh pozitiv i organizatës te studentët • Pjesëmarrja e stafit në emisione të rregullta televizive	• Ndryshimet unilaterale në ligje dhe dokumente rregulluese nga qeveria me shumicë të kualifikuar • Dallimet socio-kulturore të gjeneratave • Mungesa e profesionalizmit të disa OJQ-ve aktive në fushën e arsimit • Ndërhyrjet politike nga Qeveria • Opozita e painteresuar për opozitbërje në fushën e arsimit • Mungesa e informatave kualitative nga institucionet statistikore • Mungesa e analizave të mirëfillta sektoriale • Rezistenca ndaj ndryshimeve nga institucionet arsimore • Përndjekja ligjore e stafit të ORCA-s për shkak të aksioneve simbolike • Diskursi predominant i konflitit politik ndërshtetëror si mjet i heshtjes së incicativave për arsim • Paqëndrueshmëria ekonomike globale si pasojë e konflikteve në rritje

Shtojca 2: Plani i veprimit

Objektiva / masa	Aktiviteti		Shpjegimi i kostos (opcionale)	Kostoja	Koha e zbatimi			Gjithsejt
1. Hulumtimi dhe monitorimi					**2025**	**2026**	**2027**	**306,150 €**
Platforma e rangimit kombëtar të universitetve	Diskutimi, dizejnimi dhe përditësimi i platformës		Në 2025 parashihet themelimi i platformës që nënkupton blerjen e informacioneve në Ueb of Science dhe Scopus si dhe qasjen në LOOQME. Po ashtu do të zhvillohet instrumenti i mbledhjes automatike të informacionit nga interneti. Në vitin 2026 do të parapaguhet vetëm qasja në LOOQME, në vitin 2027 edhe qasja në LOOQME edhe në Web of Science dhe Scopus. Po ashtu ne këtë shumë janë paraparë pagesat për ekspertë (lokalë dhe ndërkombëtar) që do të ndihmojnë në dizajnimin e formulave për caktimin e peshave të indikatorëve 18,000€		80,000 €	5,000€	20,000€	105,000€
Enciklopedia e arsimit të lartë	Hulumtime vjetore		Nuk do të ketë kosto të lartë për shkak se mbledhja e informacionit, dizajnimi	3,000€	3,000€	3,000 €	3,000€	9,000€

			dhe publikimi mbulohen nga hulumtuesit e angazhuar në ORCA dhe nga teknologjia e parapaguar për qëllime të publikimit dhe promovimit. Shpenzimet eventuale mund të jenë për sponzorizim në rrjete sociale dhe në media. Një pjesë e parave do të përdoret për eventin e publikimit.					
Monitorimi i arsimit të lartë.			4 monitorues X 1,250 Euro në muaj. Rritje page 5% në vit.	60,000€	60,000 €	63,000 €	66,150 €	189,150 €
Përkthimi	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme		Ndonëse do të përdoret Inteligjenca Artificiale megjithatë një redaktim final është i nevojshëm 1000€ në vit	1000€	1000€	1000€	1000€	3000€
2. Aktivizmi, Avokimi dhe Rrjetëzimi					**2025**	**2026**	**2027**	**257,400 €**
Qendra e Aktivizmit Studentor	Organizimi i ngjarjeve me studentë: ligjërata, trajnime, klube etj.		Takime në vit: 1000 € ushqim dhe pije Trajnime në vit: 2000 (8 d/p x 250) Evente në vit: 2 x 1000 € Mbështetja e aktiviteteve të grupeve studentore në vit: 5000	10,000€	10,000€	10,000€	10,000€	30,000€
Skema e granteve për studentë	Jepja e granteve për grupe joformale studentor;		2,000€ për grup studentor. 40,000€ në vit	40,000€	40,000€	40,000€	40,000€	120,000€

Promovimi i skemës së granteve	Vizitat promovuese të skemës së granteve në universitete publike; Punëtoritë me studentë			7,200€	7,200€	7,200€	7,200€	21,600€
Kongresi i Aktivizmit Studentor	Vizita në universitete publike; punëtori me studentë nga çdo universitet publik; mbajtja e kongresit; ngjarjet avokuese pas mbajtjes së kongresit		Faza parapërgatitore, mbajtja e kongresit dhe ngjarjet avokuese pas mbajtjes së kongresit	15,000€	-	15,000€	15,000€	30,000€
Reagimet publike	Aktivitetet e presioni/përgëzimit publik			2,000€	2,000€	2,000€	2,000€	6,000€
Podcast për arsimin	Blerja e paisjeve të xhirimit, zërimit, ndriqimit		Blerja fillestare 5,000€ në vitin 2025 dhe përditësimi i teknologjisë në vitet pasardhëse.	5,000€	5,000€	1,500€	1,000€	7,500€
Qendra e trajnimeve	Trajnime të ndryshme edukuese për studentë.		Pagesa e ekspertëve dhe kosto të konsumueshme	3,000€	3,000€	3,000€	3,000€	9,000€
Rrjetëzimi në nivel kombëtar	Takime me organizata të shoqërisë civile dhe koalicionet ku bën pjesë ORCA (ROSCAP & KITU)		Nga 2 takime në vit me koalicionet dhe takimet e tjera me hisedarë nga arsimi i lartë	1,500€	1,500€	1,500€	1,500€	4,500€
Rrjetëzimi në nivel rajonal	Vizita për të krijuar partneritete me organizata rajonale dhe mirëmbajtja e partneriteteve		3 takime ndërkombëtare me qëllim rrjetëzimin	1,500€	1,500€	1,500€	1,500€	4,500€
Asistencë juridike	Pagesat për asistencë juridike		Pagesat për ekpertët eventual për ushtrimin e	1,500€	1,500€	1,500€	1,500€	4,500€

			padive, për ushtrimin e ankesave, për përgjigje në padi, për analiza juridike 1,500€ në vit					
Vizibiliteti	Pagesat për sponzorizime në rrjete sociale dhe media; Asistenca në prodhimin e materialeve audio-vizuele		50€ në muaj për sponzorizime në rrjete sociale dhe media; Angazhimi i profesionistëve të fushës si kameramanë e fotografë si dhe ekspertë të post-produksionit në raste të veçanta 1000€ në vit	1600€	1600€	1600€	1600€	4800€
Ngjarje të publikimeve	Organizimi i ngjarjeve për promovim të publikimeve dhe Ceremonive të ndarjes së çmimeve për grantin studentor më të mirë		2 ngjarje në vit me nga 100-200 pjesëmarrës, nga 2500€ për ngjarje. Vendi, ushqimi, zërimi, përkthimi, fotografimi, xhirimi	5000€	5000€	5000€	5000€	15000€
3. Adaptimi me teknologjitë e reja					**2025**	**2026**	**2027**	**14,830** €
Web dhe komunikimi	Ueb domain, hosting dhe e-mail		28€ në vit për Ueb domain; 130€ në vit për ueb hosting dhe mirëmbajtje; 224€ në vit për Google drive (për 8 llogari). Parashihet mundësia e rritjes së kostos në vitet në vazhdim.	382€	382€	400€	500€	1282€
Chatgpt	Abonimi në Chatgpt		220€ në vit. Parashihet mundësia e rrijtes së	220€	220€	300€	400€	920€

			kostos në vitet në vazhdim.					
Programet për video editim dhe dizajn grafik	Adobe Creative Cloud All Apps; Envato Elements; Canva; Visme		Adobe Creative Cloud All Apps 1200€ në vit; Envato Elements 182€ në vit; Canva 110€ në vit; Visme 136€ në vit. Parashihet mundësia e rrijtes së kostos në vitet në vazhdim.	1628€	1628€	1800€	2000€	5428€
Llaptopë	Blerja e llaptopëve		6 llaptopë nga 700€	**2800**€	2800€	700€	700€	4200€
Pajisje të ndryshme për zyre	Blerje të pajisjeve të ndryshme për zyre		Pajisje të ndryshme zëvendësuese të pajisjeve të vjetra apo që dalin nga nevoja të reja 1000€ në vit	1000€	1000€	1000€	1000€	3000€
4. Menaxhimi, procedurat dhe qëndrueshmëria					**2025**	**2026**	**2027**	**95,276 €**
Hapësira	Kontraktimi dhe furnizimi me pajisje		250 m2 objekt Qiraja mujore 1318.68€ Komunale 200€/muaj	18216€	18216€	20000€	20000€	58216€
Komunikimi	Interneti, shpenzimet telefonike		Interneti 50€ në muaj; shpenzimet telefonike 50€ në muaj	1200€	1200€	1200€	1200€	360s0€
Shpenzimet administrative	Material për administratë, shpenzime bankare,		Material për administratë 50€/muaj, shpenzime bankare 60€/muaj	1320€	1320€	1400€	1400€	4120€
Transporti	Udhëtimet brenda dhe jashtë Kosovës		Shpenzimet për taksi apo kompensime për përdorim të veturave personale - 200€ në muaj	2400€	2400€	2400€	2400€	7200€
Gjëra të konsumueshme për zyrë	Blerja e ushqimeve, ujit, pijeve etj.		Gjëra të konsumueshme për zyrë 100€/muaj	1200€	1200€	1200€	1200€	3600€

Quickbooks	Abonimi njëvjeçar			680€	680€	680€	680€	2040€
Trajnimet e stafit	Pagesa e trajnimeve grupore për stafin		Trajnim për video prodhim 500€ X 6 persona 3000€ në vit; Trajnime të tjera 1000€ X 2 persona në vit	5000€	5000€	2000€	2000€	9000€
Rishikim i rregulloreve dhe procedurave	Punëtori vjetore me stafin		Vendi, eksperti, shpenzimet e ushqimit, transporti etj. 1,500€	1,500€	1,500€	1,500€	1,500€	4,500€
Bordi dhe Kuvendi i Anëtarëve	Takime me Bordin dhe Kuvendin e Anëtarëve		500€ për Bordin; 500€ për Kuvendin e Anëtarëve	1,000€	1,000€	1,000€	1,000€	3,000€
Gjithsej								**736,656 €**